



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



15326
Nr. _____ prot.

Tiranë, më 21 / 8 .2019

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE

SI AUTORITETI KONTRAKTUES

DHE

SHOQËRIA "NOA CONTROL" SH.P.K.

SI KONCESIONARI

"SHOQËRIA KONCESIONARE NOA INSPECT" sh.p.k

SI SHOQËRIA KONCESIONARE (SPV)

KONTRATË KONCESIONI

PËR

*"SHËRBIMI I KONTROLLIT LIGJOR TË INSTRUMENTEVE MATËSE, NËPËRMJET
VERIFIKIMIT TË INSTRUMENTEVE SHPËRNDARËSE TË KARBURANTIT DHE GAZIT
TË LËNGSHËM"*

Data 21 / 8 / 2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr rep

1395

Nr kol

1091

Sot, në Tiranë në datën 21.08.2019 përpara meje Noteres Gentiana Brati, Anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, nënshkruhet Kontrata si më poshtë vijon :

**KONTRATË KONCESIONI/PPP
I KONTROLLIT LIGJOR TË INSTRUMENTEVE MATËSE, NËPËRMJET VERIFIKIMIT
TË INSTRUMENTEVE SHPËRNDARËSE TË KARBURANTIT DHE GAZIT TË
LËNGSHËM**

PALËT:

1. **MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**, që më poshtë do të quhet **“AUTORITET KONTRAKTUES”**, përcaktuar si i tillë në bazë të nenit 13 të Ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 20/06/2018 *“Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe miratimin e bonusit në procedurën konkurruese që i jepet shoqërisë”*, përfaqësuar nga z. Arian Kraja, dhe

Shoqëria “Noa Control” shpk, që në vijim do të quhet **“KONCESIONARI”**, e cila figuron e regjistruar si person juridik në QKB me NUIS: L51622005C dhe datë 22.4.2015 regjistrimi. dhe përfaqësohet nga administratori Znj. Anila Jani, e datëlindjes _____, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, me numer personal _____ dhe numër pashaporte _____ ; dhe **Shoqëria Koncesionare (SPV) “SHOQERIA KONCESIONARE NOA INSPECT”** sh.p.k me NUIS L91918012B me datë regjistrimi 18/07/2019 dhe përfaqësohet nga administratori Matiel Hoxha.

Autoriteti Kontraktues, Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare do të referohen në këtë Kontratë secili si **“Pala”** dhe së bashku **“Palët”**, sipas varianteve të tyre gjuhësore në njëjës ose në shumës. siç mund ta kërkojë herë pas here konteksti i kësaj Kontrate.



KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizime dhe interpretime

Në lidhje me këtë kontratë vlejné përkufizimet vijuese, përveç nëse lënda ose konteksti kërkojnë interpretim tjetër:

Kontrata e Koncesionit ose Kontrata: Kjo kontratë, shtojcat dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet asaj, si pjesë përbërëse dhe e pandarë.

Ligji “Për Koncesionet/PPP”: Ligji nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.

“Autoriteti Kontraktues: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

“Koncesionari” Shoqëria “Noa Control” shpk, me seli me adresë: Rr.”Nikolla Tupe”, Ndërtesa 3, Kati I, Tiranë.

Shoqëria Koncesionare është shoqëria që do të themelohet nga Koncesionari në përputhje me detyrimet e parashikuara në dispozitat e kësaj Kontrate dhe legjislacionin në fuqi.

“Objekti” Financimi, projektimi dhe kryerja e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

“Menaxheri i Projektit” quhet çdo person i emëruar i tillë nga Autoriteti dhe Koncesionari, në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

“Metrologji ligjore” është pjesë e metrologjisë, e cila rregullohet me ligj dhe dispozita të tjera, për sigurimin e saktësisë dhe të besueshmërisë në rezultatet e matjes në fushat ku aplikohen instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara.

“Tipi i instrumentit matës” është një seri instrumentesh matëse, me funksion identik, bazuar në të njëjtin parim, që kanë të njëjtin projekt dhe që janë prodhuar nga i njëjti prodhues, në bazë të të njëjtit dokumentacion teknik dhe teknologjik.

“Verifikim” është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, teknikometrologjike.

“Verifikim pasardhës” është çdo verifikim i instrumentave që kryehet pas verifikimit të mëparshëm (fillestar) dhe përfshin: verifikim periodik të detyrueshëm, verifikim jashtë radhe me kërkesë, verifikim pas riparimi.

“Verifikim i rregullt i një instrumenti matës” është një verifikim i kryer periodikisht dhe në përputhje me rregullat.

“Verifikim jashtë radhe i instrumentit matës” është një verifikim i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit.

“Verifikim fillestar i instrumenteve matëse” është kontrolli i një instrumenti të ri apo të riparuar dhe vërtetimi i përputhjes së instrumentit matës me tipin e miratuar.

“Verifikim pa tarifë jashtë frekuencës së zakonshme” është kontrolli i një instrumenti që kryhet jashtë frekuencës së zakonshme, pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktues apo Subjekteve të Detyruara, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të Subjekteve të Detyruara. Në çdo rast ky verifikim do të kryhet pa tarifë.

“Investimi” Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë dhe pajisjet e nevojshme për shërbimin, deri në fillimin e kryerjes së shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

“Pajisjet dhe makineritë e Konçesionarit”, quhen të gjitha pajisjet Hardware dhe Software dhe të gjitha laboratorët dhe pajisjet e tjera që shërbejnë për realizimin e Konçesionit, sipas dispozitave të kësaj kësaj Kontrate.

“Ditë Pune” është çdo ditë pune pa përfshirë të shtunën, të dielën dhe ditët zyrtare të festave ose pushimit në Republikën e Shqipërisë.

“Ditë kalendarike” është çdo ditë e muajit, përfshirë të shtunën, të dielën dhe ditët e festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

“Dokumentacioni i Autoritetit Kontraktues” është i gjithë dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së shpalljes së Kontratës, por jo vetëm, i cili përmban Projekt Idenë, vlerësimet dhe dokumentacionin përkatës që disponon Autoriteti Kontraktues në lidhje me Projektin.

“Dokumentet e Projektit” janë:

Nënkontratat; dhe çdo kontratë tjetër e rëndësishme e lidhur nga Konçesionari në funksion të zbatimit të Projektit dhe të identifikuar si të tilla, në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

“Efekt Negativ Thelbësor” do të thotë një pasojë apo grup pasojash që veç e veç apo së bashku e bëjnë të pamundur zbatimin nga Shoqëria Konçesionare apo Konçesionari të detyrimeve të lindura në bazë të kësaj Kontrate.

“Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës për Shkak të Mospërmbushjes së detyrimeve të Palëve” është shuma e pagueshme nga Autoriteti Kontraktues apo Koncesionari në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate.

“Kompensimi i Zgjidhjes së Kontratës në mënyrë të njëanshme” është shuma e pagueshme nga Autoriteti Kontraktues apo Koncesionari në përputhje me dispozitat e Kontratës.

“Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore” është shuma e pagueshme nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me dispozitat e Kontratës

“Plani i zbatimit të projektit” është plani i Projektit i cili përmban përshkrimin e hollësishëm të punimeve dhe afatet e shërbimeve që do të kryhen nga Koncesionari për të realizuar dhe zbatuar Projektin;

“Vënia në funksion e shërbimit: Fillimi i ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

“Data e Hyrjes në Fuqi” është data e nënshkrimit nga Palët të kësaj Kontrate. Kjo Kontratë prodhon efekte juridike dhe është detyruese për palët duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi (data e nënshkrimit nga Palët).

“Data Efektive” është data e fillimit të ofrimit të Shërbimit dhe fillimit të llogaritjes së afatit të kontratës së koncesionit.

“Dokumentat e Tenderit” janë dokumentat standarte të procedurës konkurruese për dhënien me koncesion të “shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm në Republikën e Shqipërisë” të hartuara nga Autoriteti Kontraktues.

“Kontratat” Të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari, me sipërmarrësit për realizimin e shërbimit ose çdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tretët që ka si objekt shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm.

“Leje, Liçenca dhe Akreditime” Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatës publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.

“Miratim i Nevojshëm” është çdo miratim, licensë, aprovim, lejim ose autorizim, i përkohshëm apo përfundimtar, që është i nevojshëm në lidhje me Projektin dhe ofrimin e Shërbimit dhe që duhet lëshuar nga Autoritetet Kompetente, duke përjashtuar Miratimin e Nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

“Model Financiar” është:

- a) Modeli Financiar i paraqitur në ofertën e Koncesionarit; dhe
- b) pas kësaj date, modeli i përditësuar në përputhje me këtë Kontratë.

“Mospërbushje nga Autoriteti Kontraktues” është secila prej ngjarjeve ose fakteve të mëposhtme:

- a) kalim i Kontratës tek të tretë nga Autoriteti Kontraktues në kundërshtim me dispozitat e saj;
- b) shkelje e detyrimeve të Autoritetit Kontraktues parashikuar në këtë Kontratë që e bën të pamundur ose e pengon Koncesionarin që të realizojë investimet dhe/ose Shërbimet për një periudhë më të gjatë se 1 (një) Muaj. Për të shmangur cdo dyshim, Palët bien dakord që periudha e cituar në fjalinë pararendëse përfshin gjithë Periudhën e Koncesionit.
- c) çdo Ndryshim në Ligj i cili është i paparashikueshëm dhe që e bën të pamundur ose e pengon zbatimin e Kontratës nga ana e Koncesionarit apo/dhe dëmton interesin e tij financiar dhe ekonomik sipas kësaj Kontrate;
- d) çdo Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar;

“Mospërbushje nga Koncesionari” janë kushtet e mëposhtme që ndodhin për faj të Koncesionarit dhe jo si rrjedhojë e veprimeve apo mungesës së veprimeve nga Autoriteti Kontraktues, ne perputhje me dispozitat e kesaj Kontrate:

a) Shkelja e rëndë e detyrimeve të Koncesionarit:

- i. ~~prek ndjeshem në mënyrë negative ecurinë e Projektit dhe/ose Shërbimeve si pasojë e mosperformancës se vazhdueshme në kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate, ne perputhje me dispozitat e kesaj Kontrate; ose~~
- ii. pengon ose pamundëson aftësinë e Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e parashikuara me Ligj dhe Kontratë; ose

b) Shkelje e Vazhdueshme sipas Kontratës;

- i. Në përfundim të procedurës së falimentit, vendimi përfundimtar i Gjykatës i cili pranon likuidimin kundër shoqërisë koncesionare, të lidhur me paaftësinë paguese;
- ii. Mosfillimi i zbatimit të planit të investimeve nga shoqëria koncesionare në përputhje me Projektin brenda 4 (katër) Muajve nga Data e nënshkrimit të kontratës;
- iii. Mosrespektimi për faj të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare i afatit 9 (nëntë) mujor, për fillimin e kryerjes së shërbimeve nga Data e Hyrjes në Fuqi.
- iv. Koncesionari nuk bën fillimisht dhe në vazhdimësi Sigurimet e Nevojshme sipas Kontratës;
- v. Koncesionari shkel kufizimet e vendosura në Kontratë për nënkontraktimin; dhe/ose
- vi. Koncesionari shkel kufizimet e vendosura mbi kalimin ose ndryshimin e kontrollit të parashikuara ne dispozitat e kesaj Kontrate.

“Tarifat e shërbimit” janë tarifat e parashikuara për tu paguar nga subjektet të cilët kryejnë veprimtarinë e shpërndarjes me pakicë të karburantit dhe gazit të lëngshëm nëpërmjet instrumenteve matës, sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave nr. 2 datë 08.02.2013, te percaktura dhe ne dispozitat e kësaj kontrate.

“Ndryshim Cilësues i Ligjit” është :

- a) Ndryshimi Diskriminues i Ligjit;
- b) Ndryshimi Specifik i Ligjit;
- c) një Ndryshim i Ligjit që ndodh gjatë Periudhës se investimit dhe shërbimit dhe që sjell për pasojë një Shpenzim Kapital;

“Ndryshim Diskriminues i Ligjit” është Ndryshimi i Ligjit, i cili zbatohet në mënyrë specifike

- a) për Projektin dhe jo për projekte të ngjashme;
- b) ose për Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare dhe për asnjë Person/Subjekt tjetër;

“Ndryshim në Ligj” është ndryshimi i Ligjit që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate, pa përfshirë Ndryshimet e Parashikueshme të Ligjit.

“Ndryshim nga Autoriteti Kontraktues” është ndryshimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në bazë të Kontratës.

“Ndryshim nga Koncesionari” është ndryshimi i propozuar nga Koncesionari në bazë të Kontratës.

“Ndryshim i Parashikueshëm i Ligjit” është propozimi për Ndryshim në Ligj, i bërë tridhjetë 30 (ditë kalendarike) përpara Datës së Dorëzimit të Ofertës përfundimtare në: një projektligj të qeverisë ose projektligj të paraqitur nga ministria përkatëse për konsultim dhe i bërë publik masivisht, apo i cili i është njoftuar Koncesionarit.

“Ndryshim Specifik i Ligjit” është një Ndryshim në Ligj që i referohet specifikisht ofrimit të Shërbimeve ose Punimeve të njëjta ose të ngjashme me Shërbimet dhe Punimet e parashikuara me këtë Kontratë.

“Muaj” është një muaj kalendarik gjatë Periudhës së Koncesionit. Një “Muaj” i referohet një periudhe që fillon në një ditë të një Muaji kalendarik dhe që përfundon në ditën që korrespondon numerikisht në Muajin e ardhshëm kalendarik (pa e përfshirë atë ditë), me përjashtim të rastit që, nëse nuk ka ditë që korrespondon numerikisht në Muajin në të cilin ajo periudhë përfundon, ajo periudhë do të përfundojë ditën e fundit në atë Muaj kalendarik.

“Te ardhura” janë të ardhurat totale vjetore (ndryshe referuar si xhiro totale vjetore) që realizohen nga kryerja e Shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, siç rezultojnë nga Pasqyrat Financiare të vitit përkatës.

“Pasqyrat Financiare” do të thotë pasqyrat financiare të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare për vitin financiar të Datës së Fundit Kontabël, të dorëzuara pranë autoriteteve tatimore kompetente;

“Tarifa koncesionare” shuma vjetore e shprehur në përqindje në bazë të të ardhurave nga ofrimi i shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, që i jepet Autoritetit Kontraktues.

“Llogaritja e afateve” Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

“Subjektet e Detyruara” janë të gjithë subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e shitjes me pakice të karburanteve dhe gazit të lëngshëm, që janë të detyruara sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas

kësaj Kontrate t'i nenshtrohen shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matës, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarës të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës.

“Sigurimi i kontratës” Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari bankare të posaçme ose në një shoqëri sigurimesh, me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Koncesionari, sipas dispozitave të kësaj kontrate.

Ligj: Nënkupton çdo ligj organik, dekret, Vendim të Këshillit të Ministrave ose çdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullore, udhëzim, urdhër, licensë, leje, autorizim ose çdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të lëshuara nga çdo organ qëndror dhe/ose vendor, ashtu siç mund të ndryshojnë gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.

“Shtojca” Çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga palët që i bashkëlidhet kësaj Kontrate, si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj, tani apo në të ardhmen.

Instrument Financiar: Nënkupton çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguroese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e objektit të këtij koncesioni, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.

Pala Financuese: Nënkupton institucionet financiare të liçencuara si të tilla, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e objektit të koncesionit.

“E Drejta për akses në pikat e karburanteve dhe gazit të lëngshëm” është e drejta ekskluzive që i jepet Koncesionarit për të patur akses të lirë në realizimin e detyrimeve të marra përsipër në këtë kontratë koncesioni.

“Pikat e karburanteve edhe gazit të lëngshëm” ose **“Pikë”** janë të gjitha ato stacione të shitjes së karburanteve që ushtrojnë veprimtarinë tregtare në lidhje me karburantet dhe gazin e lëngshëm nëpërmjet instrumenteve matëse.

“Palë e tretë” do të kuptohet çdo individ, person fizik, juridik, shoqëri tregtare, që nuk ka lidhje me asnjë nga Palët dhe nuk përfshin shoqërinë e lidhur, sipas përkufizimit të dhënë në këtë kontratë.

“Shkak Kompensimi” është:

- a) shkelje nga ana e Autoritetit Kontraktues e çdo detyrimi material të parashikuar me këtë Kontratë që e bën Koncesionarin të mospërbushë detyrimet e parashikuara me këtë Kontratë, për një periudhë më të gjatë se 30 (tridhjetë) Ditë Kalendarike. Për të shmangur çdo dyshim, Palët bien dakord që periudha e përmendur në fjalinë pararendëse do të përfshijë gjithë Periudhën e Koncesionit.
- b) mungesa e miratimeve, lejeve dhe akreditimeve të Autoriteteve jo për faj të Koncesionarit;

“Shkak Lehtësimi” është: zjarri, shpërthimet ose ngjarje e paparashikuar e motit ekstrem dhe çdo ngjarje e parashikuar si “Ngjarje e Focës Madhore” në këtë kontratë.

“Palë e Autoritetit Kontraktues” është veçmas Autoriteti Kontraktues dhe nëpunësit, punëmarrësit dhe agjentët e tij dhe çdo nënkontraktor apo Person i punësuar ose i angazhuar nga secili prej tyre (ku përfshihen edhe Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues dhe Përfaqësuesi teknik, por pa përfshirë Koncesionarin dhe Palët Koncesionare) si dhe organet e tjera përkatëse të tjera që sipas rastit asistojnë Autoritetin Kontraktues për zbatimin e Kontratës.

“Shoqëri e Lidhur”, ka kuptimin e çdo shoqërie që zotëron Kontrollin e asaj shoqërie, çdo shoqëri që është nën Kontrollin e asaj shoqërie, ose çdo shoqëri e varur, e cila ka Kontrollin mbi atë shoqëri. Çdo shoqëri e llojit holding (që zotëron Aksionet/Kapitalet e shoqërive të tjera) që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare, çdo shoqëri tregtare mbi të cilën ushrohet kontroll nga ajo shoqëri tregtare ose çdo shoqëri e kontrolluar e një shoqërie të llojit holding që ushtron kontroll mbi atë shoqëri tregtare.

“Palë Koncesionare” është veçmas Koncesionari, Shoqëria Koncesionare, Nënkontraktori, Përfaqësuesi i Koncesionarit.

“Gëzim i qetë” do të thotë e drejta ekskluzive për të projektuar, financuar dhe kryer shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, gjatë Afatit të kësaj Kontrate Koncesionare dhe në përputhje me të, pa ndërhyrje të parregullta nga Autoriteti Kontraktues ose nga ndonjë Entitet Shtetëror.

“Ngjarje e Forcës Madhore” është një ngjarje që nuk është në kontrollin e Palëve dhe që sjell për pasojë që Pala që e pretendon të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë (**“Pala e Prekur”**), përfshirë, pa u kufizuar në:

- a) çdo akt i natyrës duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në to, zjarrin, përmytjen, ose çdo katastrofë tjetër natyrore si, tërmeti, uragani, tornado ose goditja nga meteori ose nga një trup tjetër qiellor;
- b) pushtimi i territorit, lufta, kryengritja, revolucioni, lufta civile, konflikti i armatosur, gjendja e jashtëzakonshme e vendosur me Ligj;
- c) rrezatimi jonizues ose kontaminimi kimik apo biologjik;
- d) shpërthimet e shkaktuara nga pajisjet supersonike;
- e) shpërthimi bërthamor ose kontaminimi radioaktiv;
- f) çdo rast tjetër i parashikuar në një dispozitë të Kontratës si e tillë.

“Njoftim për Ndërprerje dhe/ose Përfundim të Kontratës” është:

- a. Njoftimi për Mospërmbushje të Detyrimeve nga Koncesionari;
- b. Njoftimi për Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktues; ose
- c. Njoftimi për Përfundim të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.
- d. Njoftimi për Përfundim të Kontratës Jo për Mospërmbushje, sipas rasteve të parashikuara në Kontratë.

“Njoftimi për Përfundim të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore” ka kuptimin e dhënë në këtë Kontratë.

“Norma e Brendshme e Kthimit të Kapitalit” është norma e brendshme e kthimit të Kapitalit të Investuar të Koncesionarit, sipas përlogaritjeve të bëra në Modelin Financiar, përfshirë ndryshimet që ai mund të ketë sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

NENI 2

INTERPRETIMI I KONTRATËS

Në këtë Kontratë, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, do të përdoren interpretimet e mëposhtme:

- 2.1 Një fjalë e përdorur në numrin njëjës përfshin dhe numrin shumës dhe anasjelltas. Referimi të njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër;
- 2.2 Një "Palë" i referohet koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare ose Autoritetit Kontraktues, sipas rasteve të zbatueshme;
- 2.3 Referimi i një Ligji, akti administrativ, urdhëri apo udhëzimi përfshin referim tek ai Ligj. akti administrativ, urdhëri apo udhëzim siç është ndryshuar, shtuar apo rimiruar kohë pas kohe, si dhe çdo rregullore e nxjerrë në bazë e për zbatim të tij. Pasoja e çfarëdo ndryshimi, shtese apo ri-miratimi të tillë mbi këtë Kontratë do të zgjidhet në përputhje me nenet e kësaj Kontrate;
- 2.4 Referenca për një Palë përfshin pasardhësit e tij apo Palet e autorizuar nga ai në bazë të Ligjit;
- 2.5 Referenca ndaj çdo Neni, paragrafi ose Shtojce, përveç kur deklarohet shprehimisht për të kundërtën, është referencë ndaj atij Neni, paragrafi ose Shtojce të kësaj Kontrate;
- 2.6 Referencat për këtë Kontratë ose ndonjë dokument tjetër të përfshirë në të nënkupton një referencë ndaj çdo ndryshimi/amendimi ose shtesë të kësaj Kontrate, siç mund të ndodhë herë pas here;
- 2.7 Kjo Kontratë përfshin edhe Shtojcat e saj;
- 2.8 Titujt dhe renditja numerike e përdorur për nenet, paragrafët, nënparagrafët, shtojcat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
- 2.9 Një referim të secili institucion apo organ vendimarrës i referohet institucionit dhe organit vendimarrës ekzistues si dhe nëse ai institucion apo organ vendimarrës pushon së ekzistuari, ristrukturohet apo ndan përgjegjësitë me institucione apo organe të tjera, i referohet institucionit apo organit vendimarrës pasardhës apo institucionit apo organit që trashëgon përgjegjësite ekzistuese apo që shërben për të kryer funksione dhe qëllime të ngjashme apo të njëjta si institucioni apo organi ekzistues.
- 2.10 Përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kontratë, në rast të një konflikti të drejtpërdrejtë midis ndonjë dispozite të pjesës kryesore të Kontratës, të ndonjë Shtojce ose Dokumentacionit të Procedurës së Tenderit radha e përparësisë do të jetë si më poshtë:
- a. kjo Kontratë;
 - b. Shtojcat e saj;
 - c. Dokumentacioni i ofertës
 - d. Dokumentat e Procedurës së Tenderit;

NENI 3 OBJEKTI I KONCESIONIT

- 3.1 Objekti i koncesionit është kryerja nga Koncesionari/Shoqëria koncesionare e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (referuar si "Shërbimi" ose "Projekti").
- 3.2 Realizimi i objektit të koncesionit do të kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, shtojcat e saj, si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

- 3.3 Koncesionari ka të drejtën e vetme dhe ekskluzive të kryejë shërbimin e objektit të kësaj kontrate në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë gjithë Periudhës Koncesionare. Në asnjë rast Autoriteti Kontraktues apo çdo institucion ose ent shtetëror të çfarëdo niveli, apo tjetër organizatë me funksione publike të deleguara, nuk do të lidhë kontratë apo licensojë, autorizojë apo të kryejë çfarëdo veprimi që do të kalonte në pjesë apo gjithë Shërbimin ndonjë pale tjetër, osë të ndërmarrë ndonjë veprim duke përfshirë përfundimin e Kontratës që mund të ndikojë negativisht në këtë të drejtë të dhënë Koncesionarit, sipas kësaj kontrate.


NENI 4 KONCESIONARI DHE SHOQËRIA KONCESIONARE

- 4.1 Palët pranojnë që në përputhje me Ligjin, Koncesionari ka themeluar Shoqërinë Koncesionare për të realizuar këtë Kontratë. Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare janë solidarisht përgjegjës për përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate.
- 4.2 Në varësi të kushteve të parashikuara në këtë Kontratë :
- a) Koncesionari/Shoqëria Koncesionare ka të drejtën dhe detyrimin ekskluziv (i) të realizojë Projektin sipas propozimit teknik të paraqitur në ofertë (ii) të sigurojë financimin për zbatimin e Projektit, (iii) të realizojë shërbimin në përputhje me praktikat më të mira të industrisë. Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, Koncesionari /Shoqëria koncesionare ka të drejtën ekskluzive për të ushtruar të drejtat e përcaktuara në këtë Kontratë në lidhje me këtë objekt.
 - b) Autoriteti Kontraktues garanton se nuk do t'ia bartë ose cedojë ndonjë personi tjetër në çfarëdo forme, me apo pa shpërblim, të drejtat e Koncesionarit ose ndonjë prej detyrimeve të Koncesionarit sipas kësaj Kontrate.
 - c) Autoriteti Kontraktues është i detyruar (i) të plotësojë të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë, (ii) të angazhohet për të mbështetur dhe asistuar Koncesionarin/Shoqërinë koncesionare për aplikimin dhe marrjen e të gjitha lejeve, licencave dhe akreditimeve në lidhje me Projektin, (iii) Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit të drejtën si dhe e detyron atë që gjatë kohëzgjatjes së Kontratës dhe sipas kushteve të kësaj Kontrate të kryejë shërbimet e përcaktuara në këtë kontratë, (iv) të arkëtojë tarifat sipas dispozitave të lejuara me këtë Kontratë.

NENI 5 REFERENCAT NDAJ KONCESIONARIT DHE SHOQËRISË KONCESIONARE

- 5.1 Referencat ndaj Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare në këtë Kontratë, do të konsiderohen si referime për të dyja Palët për efekt të kryerjes së Shërbimit.
- 5.2 Palët pranojnë që, në përputhje me Ligjin, si dhe me Dokumentat e Procedurës Konkurruese, Koncesionari ka themeluar Shoqërinë Koncesionare për të realizuar këtë Kontratë, në vend të Koncesionarit. Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare janë solidarisht përgjegjës për përmbushjen e kushteve të kësaj Kontrate.

NENI 6
KONTROLLET METROLOGJIKE LIGJORE TË VERIFIKIMIT TË
INSTRUMENTEVE SHPËRNDARËSE TË KARBURANTIT DHE GAZIT TË
LËNGSHËM



- 6.1 Shërbimi i kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm do të kryhet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e kësaj kontrate dhe Shtojcën 1 dhe do të përfshijë:
- a) Verifikimin fillestar
 - b) Verifikim pasardhës që përfshin :
 - 1. Verifikim periodik të detyrueshem të një instrumenti matës.
 - 2. Verifikim jashtë radhe me kërkesë të Subjektit të Detyruar.
 - 3. Verifikim pas riparimit.
 - c) Verifikim pa tarifë jashtë frekuencës së zakonshme.
- 6.2 Koncesionari lëshon certifikatën e verifikimit/inspektimit edhe në rastet që instrumenti matës ka të fiksuar tashmë shenjën e verifikimit.
- 6.3 Verifikimi i një instrumenti matës ligjërisht të kontrolluar nuk është i vlefshëm nëse:
- a) ka mbaruar periudha e verifikimit;
 - b) instrumenti matës i nënshtrohet një modifikimi/riparimi nga pale te treta, që ndikon në karakteristikat e tij metrologjike;
 - c) instrumenti matës është dëmtuar në një mënyrë të tillë, që ai humbet disa karakteristika të tij thelbësore të verifikimit të mundshëm ose qëllimin e tij të përdorimit;
 - ç) shenja e verifikimit është shkatërruar;
 - d) është e qartë se instrumenti matës ka humbur karakteristikat metrologjike të kërkuara, megjithëse shenja e verifikimit nuk është dëmtuar;
 - e) vendi i instalimit të instrumentit matës është ndryshuar.

NENI 7
PERIUDHA E KONCESIONIT

- 7.1 Koncesioni jepet për një periudhë prej 20 (njëzet) vjetësh nga Data Efektive dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 20-të të Datës Efektive ("Periudha Efektive").
- 7.2 Data Efektive e fillimit të Koncesionit do të jetë data në të cilën do të jenë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:
- i. nënshkrimi i kësaj Marrëveshje nga të dyja Palët;
 - ii. krijimi i Shoqërisë Koncesionare që do të implementojë Koncesionin;
 - iii. njoftimi nga ana e Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare për datën e fillimit të Shërbimit, sipas dispozitave të nenit 17 të kësaj Kontrate.
- 7.3 Me përmbushjen e kushteve të mësipërme, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do t'i dërgojë Autoriteti Kontraktues njoftimin mbi Datën Efektive të fillimit të Koncesionit. Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi, Autoriteti Kontraktues duhet të njoftojë të gjithë Subjektet e Detyruara për kalimin e këtij shërbimi të Shoqëria Koncesionare. Me aprovimin me shkrim të Koncesionarit, njoftimi për Subjektet e Detyruara mund të përmbajë dhe elementë të kësaj Kontrate, që përfshijnë, por nuk kufizohen në, tarifatat dhe të drejta specifike të Koncesionarit kundrejt Subjekteve të Detyruara.

- 7.4 Autoriteti Kontraktues angazhohet që t'i dorëzojë Shoqërisë Koncesionare, brenda 45 ditësh kalendarike nga Data e Hyrjes në Fuqi, bazën e të dhënave komputare për të gjithë verifikimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë në 12 muajt e fundit para firmosjes së kësaj Kontrate. Pas kësaj, çdo 14 ditë kalendarike, deri në fillimin e Shërbimit, Autoriteti Kontraktues duhet të dorëzojë databazat për verifikimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë këtyre 14 ditëve. Databazat duhet të dorëzohen në format elektronik dhe fizik dhe të përfshijë minimalisht të dhënat ligjore të Subjektit të verifikuar (Emri i saktë i Subjektit, NUIS, Adresa e saktë), të dhënat teknike (numri i distributorëve, llojet e distributoreve sipas karburantit – naftë/benzinë/gaz i lengshëm), tipet e verifikimit të kryer, datat e verifikimit, rezultatet si dhe kopje të fletëve të punës për secilin verifikim të kryer.
- 7.5 Palët bien dakort se kohëzgjatja e Konçesionit do të shtyhet, vetëm kur ekzistojnë arsyet e mëposhtme objektive të pavarura nga vullneti i Palëve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë dhe vonojnë zbatimin e Projektit të Konçesionit. Në çdo rast, shtyrja e afatit nuk do të jetë më e shkurtër se periudha e vonesës së shkaktuar.
- 7.6 Palët bien dakort se kohëzgjatja e Konçesionit do të shtyhet në rast të një ngjarje të konsideruar Forcë Madhore, kohëzgjatja e së cilës nuk kalon 120 ditë, për një periudhë kohore të barabartë me kohëzgjatjen e Forcës Madhore dhe për periudhën kohore që në mënyrë të arsyeshme konsiderohet e nevojshme për të ndrequr dëmet e shkaktuara.
- 7.7 Në rast se Konçesionari ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë të Kontratës së Koncesionit, Konçesionari duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues me shkrim për vonesën, shkakun dhe periudhën e ndërprerjes së shërbimeve. Autoriteti Kontraktues duhet të vlerësojë objektivisht kërkesën dhe në rast se është dakort me vonesën, shtyrja e afatit do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të Kontratës.
- 7.8 Në rastin kur kushtet paraprake të përcaktuara në këtë nen, nuk janë përmbushur, Palët do të takohen për të vendosur për një rrugëzgjidhje për plotësimin e kushteve paraprake të mbetura. Në rast se kushtet paraprake të mbetura nuk janë përmbushur ende brenda 3 (tre) Muajve nga data e propozuar, ose brenda ndonjë datë tjetër, për të cilën Palët do të bien dakord me shkrim, Autoriteti Kontraktues është i detyruar të shtyjë afatin e kësaj Kontrate në përputhje me kohëzgjatjen përkatëse deri në plotësimin e kushteve paraprake të mbetura. Në rast se Autoriteti Kontraktues nuk përmbush kushtet paraprake të mbetura brenda një afati 12 (dymbëdhjetë) mujor nga Data e Hyrjes në Fuqi, Palët bien dakord se Koncesionarit i lind e drejta ta konsiderojë kete Kontratë të zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë rast, Palët bien dakord ti referohen dispozitave të kësaj Kontrate për Zgjidhjen e Njëanshme të Kontratës.
- 7.9 Në rastin e mospërmbushjeve me faj nga Koncesionari të kushteve paraprake, Autoriteti Kontraktues do të mbajë Garancinë e Kontratës, si kompensim i rënë dakord paraprakisht.
- 7.10 Rastet e zgjatjes së Periudhës së Koncesionit:
- 7.10.1 Palët bien dakord se për shkaqe që ndikojnë drejtpërdrejt në Projekt (jo të shkaktuara nga Koncesionari) ku përfshihet vetëm Forca Madhore, periudha e koncesionit do të zgjatet në përputhje me kohën e duhur që projekti të konsiderohet si rentabël.
- 7.10.2 Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabartë me kohën që ka zgjatur Ngjarja dhe kohën e arsyeshme që nevojitet për riparimin e dëmeve të shkaktuara.

NENI 8

REALIZIMI I KONCESIONIT

- 8.1 Faza e Projektit: Konçesionari duhet të realizojë dizenjimin e plotë të Projektit brenda 90 ditëve nga Data e Hyrjes ne Fuqi. Palet bien dakord qe Autoriteti Kontraktues do te shqyrtoje dhe miratoje brenda 15 ditesh kalendarike projektin e paraqitur nga Koncesionari, nëse ky Projekt nuk është në kundërshtim thelbësor me projektin e paraqitur nga Koncesionari në ofertën teknike.
- 8.2 Faza e Zbatimit:
- 8.2.1 Konçesionari do të kryejë investimet e nevojshme për realizimin e Projektit, siç specifikohet në Shtojcën 5 të kësaj Kontrate;
- 8.2.2 Shërbimi i Kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm është në përputhje me Ofertën Teknike, me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, si dhe përcaktimet e Shtojcës 5 të kësaj Kontrate;
- 8.2.3 Konçesionari do të rinovojë sistemin on line nëpërmjet përditësimit dhe përgjatë kohëzgjatjes së Koncesionit dhe përpara përfundimit të afatit të tij. Përcaktimi i rinovimit të sistemit dhe të pajisjeve duhet të bëhet në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara ne Shtojcën 5 të kësaj Kontrate.
- 8.2.4 Konçesionari do të marrë masa për trajnimin e përshtatshëm të personelit të tij.
- 8.2.5 Konçesionari do të përdorë teknologjinë e përcaktuar në Ofertën Teknike
- 8.3 Gjatë kohëzgjatjes, Shoqëria Koncesionare bie dakord të kryejë Shërbimin duke përdorur pajisjet e përmendura në Shtojcën 2, ose pajisje ekuivalente (këto pajisje së bashku me të gjitha zëvendësueset dhe përfshirë punimet civile dhe sistemet e lidhura me to, referohen bashkërisht si "pajisjet") sipas termave dhe kushteve të kësaj Kontrate. Gjatë gjithë kohëzgjatjes të gjitha pajisjet do të mbeten pronë e Shoqërisë Koncesionare.
- 8.4 Gjatë kohëzgjatjes, Shoqëria Koncesionare do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e pajisjeve në kushte të mira operuese dhe të arsyeshme dhe në përputhje me specifikimet e performancës operuese siç përcaktohet në Shtojcën 2. Shoqëria Koncesionare rezervon të drejtën për të modifikuar dizenjimin dhe specifikat e pajisjeve, me kusht që modifikimi, sipas arsytimit të logjikshëm të Shoqërisë Koncesionare, nuk ndikon negativisht operimin e pajisjes. Shoqëria koncesionare ka të drejtën të zëvendësojë çdo komponent ose pjesë të pajisjes me një pjesë të dobishme funksionale të një niveli të barabartë ose më të lartë të efektshmërisë.
- 8.5 Pronësia mbi pajisjen do të mbetet te Shoqëria Koncesionare gjatë gjithë kohëzgjatjes dhe Autoriteti Kontraktues bie dakord të mos ngrejë asnjë pretendim të mos kryejë asnjë veprim apo të mos bëjë asnjë deklaratë për heqjen e pronësisë së pajisjeve nga Shoqëria Koncesionare. Gjatë kohëzgjatjes, Autoriteti do të mbajë pajisjen të lirë dhe të çliruar nga çdo peng, barrë apo pretendim të çdo lloji. Pas përfundimit të Periudhës së Koncesionit, pronësia mbi këto pajisje, do t'i kalojë Autoritetit Kontraktues.

NENI 9 GARANCIA E KONTRATËS

- 9.1 Koncesionari, para nënshkrimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose të sigurojë në një shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 7,000.000 (shtatë milion) lekë, që përbën 10 % të vlerës totale të investimit për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.
- 9.2 Koncesionarit nuk do të ç'ngurtësojë këtë vlerë përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit pa miratimin e Autoritetit Kontraktues.
- 9.3 Garancia e Kontratës dhënë si më lart:
- 9.3.1 Është një instrument që mbulon të gjitha detyrimet e Koncesionarit, që rrjedhin nga kjo Kontratë, e cila mbahet nga Autoriteti Kontraktues në rastin e mospërbushjeve të Kontratës nga Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare;
- 9.3.2 Emërton Autoritetin Kontraktues si përfitues të drejtpërdrejtë; dhe
- 9.3.3 Pas dorëzimit të Garancisë së Kontratës tek Autoriteti Kontraktues, ky i fundit menjëherë nga data e paraqitjes së saj e shqyrton atë, dhe nëse Garancia e Kontratës është në përputhje me parashikimet e mësipërme, Autoriteti Kontraktues e pranon dhe rikthen menjëherë tek Koncesionari Garancinë e Ofertës. Në rast të mos kthimit nga ana e Autoritetit Kontraktues të Garancisë së Ofertës tek Koncesionari brenda një afati prej 10 (dhjetë) Ditësh Pune nga data e dorëzimit të Garancisë së Kontratës, atëherë Autoriteti Kontraktues do të paguajë një penaltitet në vlerën prej 0.1 % të vlerës së Garancisë së Ofertës për çdo ditë vonesë.
- 9.4 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ekzekutojë sigurimin e kontratës, në masën e parashikuar në këtë kontratë, për:
- (i) Kompensimin e dëmit të shkaktuar nga Koncesionari te Autoriteti Kontraktues si pasojë e shkeljes së Koncesionarit të detyrimeve dhe garancive të tij parashikuar në këtë Kontratë;
 - (ii) Kompensimin e dëmit dhe shpenzimeve të cilat i shkaktohen Autoritetit Kontraktues për shkak se Autoriteti Kontraktues ushtron të drejtën e tij për ndërhyrje sipas kësaj kontrate;
 - (iii) Përbushjen e pagesës së penaltiteteve që duhet të paguhet nga Koncesionari parashikuar në këtë Kontratë;
- 9.5 Autoriteti Kontraktues ka për detyrë ta njoftojë koncesionarin me shkrim për çdo ekzekutim të sigurimit të kontratës si dhe të arsyes të ekzekutimit. Në rast të ekzekutimit të sigurimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, koncesionari ka për detyrë që brenda 15 ditëve nga dita e ekzekutimit të sigurimit të kontratës të sigurojë që Sigurimi i Kontratës të ketë vlerën që e ka pasur në kohën kur është ekzekutuar Sigurimi i Kontratës dhe siç kërkohet me këtë kontratë. Ekzekutimi i sigurimit të kontratës nga Autoriteti Kontraktues nuk i përjashton mjetet e tjera juridike të cilët i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kësaj kontrate.

NENI 10 NEN KONTRATAT

- 10.1 Gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate, Koncesionari ka të drejtë të përdorë dhe t'ia besojë personave të tretë në cilësinë e nën-kontraktorëve përmbushjen e një ose më shumë detyrimeve dhe shërbimeve sipas kësaj kontrate. Koncesionari është tërësisht përgjegjës për veprimet, vonesën dhe pakujdesinë e nën-kontraktorëve të tij si dhe të përfaqësuesve dhe

- punëtorëve të nën-kontraktorëve sikur të ishin veprimet, vonesat dhe pakujdesia e vet Koncesionarit.
- 10.2 Koncesionari ka për detyrë të mbajë një regjistër të të gjithë nënkontraktorëve si dhe nga një kopje të të gjitha kontratave të lidhura me nënkontraktorët.
- 10.3 Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nënkontraktuesin:
- i. Emrin e tij dhe adresën;
 - ii. Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe
 - iii. Vlerën e nënkontratës
 - iv. Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

NENI 11 NDRYSHIMI I KONTROLLIT

- 11.1 Në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi për Koncesionet/PPP, me pëlqimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues, kontrata e koncesionit /partneritetit publik privat mund të transferohet te një person i tretë, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të të cilit kontrata ishte dhënë fillimisht, përveçse nëse këto kërkesa u referohen kushteve që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e kontratës, për shkak të faktit se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga koncesionari/partneri privat i mëparshëm.
- Në rast se ka ndonjë ndryshim në Kontrollin e Koncesionarit në cilësinë e ortakut të Shoqërisë Koncesionare, Koncesionari është i detyruar të marrë miratimin e Autoritetin Kontraktues, miratim që duhet të jepet nga Autoriteti Kontraktues brenda 20 (njëzetë) Ditësh Pune pas kërkesës për një ndryshim të tillë. Palet bien dakord qe ndryshim ne Kontroll do te thote kur Koncesionari ka tjetersuar jo me pak se 50% te kuotave te Shoqerise Koncesionare.
- Kur Koncesionari është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të subjektit për qëllime të veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, mund të zbatohet pa miratimin e Autoritetit Kontraktues, nëse ky është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.
- 11.2 Autoriteti Kontraktues do të marrë vetëm një njoftim nga Koncesionari për çdo transferim të aksioneve/kuotave dhe të kontrollit brenda Shoqërisë Koncesionare dhe për çdo transferim të kuotave/aksioneve dhe kontrollit nga çdo Aksioner tek/ndaj një Shoqëri e Lidhur, e tij, apo tek një Aksioner tjetër, ose tek/ndaj një Shoqëri e Lidhur e një Aksioneri tjetër.

NENI 12 GARANCITË DHE ANGAZHIMET E KONCESIONARIT/ SHOQËRISË KONCESIONARE

- 12.1 Garancitë e Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare:

Koncesionari/Shoqëria Koncesionare deklaron, garanton, dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktues se:

- 12.1.1 Është themeluar dhe vepron në përputhje me Ligjin;
- 12.1.2 Në dijeninë e tij, nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që do ta bënte Koncesionarin të mos ishte në gjendje të përmbushte detyrimet e tij dhe nuk ekziston asnjë fakt ose ngjarje që mund të shpinte në mospërmbushjen e detyrimeve të Koncesionarit; dhe
- 12.1.3 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Koncesionari apo Shoqëria Koncesionare nuk kanë kryer asnjë veprim të ndaluar nga Ligji.
- 12.1.4 Koncesionari më tej garanton, deklaron dhe merr përsipër përpara Autoritetit Kontraktues se, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi:

- (i) Çdo angazhim që buron nga Dokumentet e Projektit përfaqëson një angazhim të vlefshëm dhe të zbatueshëm të Koncesionarit dhe secili nga Dokumentet e Projektit është në formën që kërkohet nga Ligji;
- (ii) Dokumentet e Projektit janë përgatitur dhe zbatimi i tyre nga Koncesionari nuk bie ndesh me: Asnjë Ligj; Aktin e themelimit ose dokumente të tjera të brendshme të Koncesionarit; ose Detyrimet e Koncesionarit;
- (iii) Ndaj Koncesionarit nuk është ngritur asnjë padi dhe nuk ka asnjë proces gjyqësor, arbitrazhi ose procedurë administrative në pritje për t'u zgjidhur apo ndonjë mosmarrëveshje tjetër e cila është duke u zgjidhur në ndonjë mënyrë tjetër. dhe Koncesionari nuk ka dijeni, me gjithë kujdesin e treguar, për ndonjë mosmarrëveshje në pritje për t'u zgjidhur apo mosmarrëveshje që mund të lindë në të ardhmen, që mund të ketë Efekt Negativ Thelbësor.

12.2 Angazhimet e Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare

12.2.1 Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do të:

- a) vihet në dijeni për të drejtat që do të përfitojë dhe natyrën dhe shkallën e risqeve që do të ndërmerren sipas kësaj Kontrate;

12.2.2 Pa çënuar përfitimet (të drejtat) e Shoqërisë Koncesionare sipas kësaj Kontrate. Shoqëria Koncesionare garanton se:

- b) Shoqëria Koncesionare angazhohet se do të lejojë Autoritetin Kontraktues dhe përfaqësuesit e tij të kenë akses në të gjitha fazat e zbatimit të kontratës për të siguruar që koncesionari vepron në pajtim me detyrimet e tij sipas kontratës.

NENI 13

GARANCITË DHE MONITORIMI NGA AUTORITETI KONTRAKTUES

13.1 Autoriteti Kontraktues garanton se:

- 13.1.1 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në rast ndarje, bashkim ose portfolesh eventuale sipas ligjeve në fuqi, shprehja Autoritet Kontraktues do t'i referohet ministrit përgjegjës për politikën e metrologjisë në Republikën e Shqipërisë.
- 13.1.2 Ka ndjekur të gjitha procedurat Ligjore në lidhje me organizimin e procedurave konkurruese si dhe ato të përzgjedhjes së Koncesionarit si dhe ka konsultuar, ndjekur dhe respektuar manualin, udhëzimet dhe rekomandimet e publikuara nga autoritete të

- tjera, të cilët ngarkohen me Ligj të mbikëqyrin sektorë të tjerë, subjekte të Ligjeve të veçanta.
- 13.1.3 Organizimi i procedurave të dhënies me Koncesion, përzgjedhja si dhe përmbajtja e Kontratës nuk rezultojnë në ndonjë shkelje të ndonjë marrëveshjeje me palë të treta, të ndonjë Ligji tjetër të sektorëve/të veçantë, të manualeve dhe rekomandimeve të dhëna nga autoritete të tjera sipas Ligjeve të veçanta, të ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare, traktati apo konvente, ku Autoriteti Kontraktues dhe Republika e Shqipërisë janë palë ose në bazë të të cilave kanë marrë angazhime.
- 13.1.4 Autoriteti Kontraktues garanton se nuk do të ndërmarrë asnjë veprim i cili do të ndërpresë ose do të pengojë kryerjen e shërbimeve, si dhe arkëtimin e tarifës nga Koncesionari. Në rast të një ndërprerje të përkohshme të palejuar nga ana e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë t'ia kompensojë Koncesionarit të gjitha shpenzimet, humbjet dhe fitimin e munguar, të cilat i shkaktohen Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare si pasojë e kësaj ndërprerje.
- 13.1.5 Autoriteti Kontraktues garanton se do të mbajë të pacënuar Shoqërinë Koncesionare nga çdo ndryshim thelbësor, që mund të cënojë rentabilitetin ekonomik të tij. Për të shmangur çdo dyshim, me qëllim mbajtjen të pacënuar të Shoqërisë Koncesionare, në rast të një ndryshimi të tillë, Palët do të ulen në mirëbesim për të përcaktuar që rivendosja e stabilitetit ekonomik të Shoqërisë Koncesionare do të realizohet duke i dhënë të drejtën Shoqërisë Koncesionare, që të bëjë rishikimin e tarifave të shërbimit, në përputhje me treguesit e performancës financiare të koncesionarit, të paraqitur në garë.
- 13.1.6 Autoriteti Kontraktues ka për detyrë që:
- a) të sigurojë gjatë tërë kohëzgjatjes së kontratës posedimin e qetë në dobi të Koncesionarit dhe;
 - b) të sigurojë që pas datës së Kontratës nuk do të krijojë të drejta në lidhje me këtë objekt kontrate, përveç në mënyrën e përcaktuar në këtë kontratë.
- 13.1.7 Autoriteti Kontraktues angazhohet se do të ndërmarrë të gjithë hapat e duhur dhe do të japë të gjithë asistencën e nevojshme konkrete si dhe do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Autoritetet Përkatëse kompetente, qendrore ose vendore, të cilat kanë kompetencë për lëshimin e lejeve, licencave dhe akreditimeve përkatëse kundrejt Shoqërisë Koncesionare në mënyrë që këto autoritete të pajisin Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare me lejet, licencat dhe akreditimet përkatëse, në kohë dhe pa vonesë në lidhje me zbatimin e Kontratës, për sa kohë që ky i fundit ka përmbushur detyrimet e tij për aplikim në përputhje me Ligjin.
- 13.1.8 Autoriteti Kontraktues angazhohet se gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj Kontrate do të sigurojë gëzimin e qetë të të drejtave që Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare i lindin nga kjo Kontratë.
- 13.1.9 Autoriteti Kontraktues gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj Kontrate do të sigurojë mos cënimin nga palë të treta të aktivitetit të Shoqërisë Koncesionare si dhe do të ndërmarrë të gjitha masat për të zgjidhur problemet që palë të treta do të kenë dhe/ose pretendojnë në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate.
- 13.1.10 Autoriteti Kontraktues do t'ia garantojë Shoqërisë Koncesionare, vetë apo kur është rasti në bashkëpunim me Autoritetet e tjera Përkatëse, gëzimin e qetë dhe aksesin në Pikat gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate.
- 13.1.11 Autoriteti Kontraktues merr përsipër që, gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të ndihmuar Shoqërinë Koncesionare në përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate dhe në përputhje me të, si dhe të mos krijojë asnjë pengesë kundrejt Shoqërisë Koncesionare në lidhje me zbatimin e Kontratës.

- 13.1.12 Pavarësisht nga çdo klauzolë tjetër e kësaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues në të gjitha rastet bashkëpunon me mirëbesim dhe i ofron asistencë të arsyeshme Koncesionarit apo Shoqërisë Koncesionare.
- 13.2 Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme, Njësia e Zbatimit të Projektit
- 13.2.1 Autoriteti Kontraktues ngre Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZP) e cila është një strukturë e cila ngarkohet me mbikëqyrjen e ecurisë së kësaj kontrate.
- 13.2.2 Autoriteti Kontraktues, nëpërmjet NJZP-së ka të drejtë që në periudha kohore prej 24 (muajsh) muajsh gjatë gjithë periudhës së koncesionit, të monitorojë në vend objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj. Pavarësisht këtij parashikimi, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate. Cdo monitorim do të kryhet me një njoftim parapaprak prej të paktën një muaji.
- 13.3 Mbikqyrja e përgjithshme e Shërbimit
- Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë mbikqyrje të përgjithshme nepermjet shqyrtimit të raporteve që dorezon Koncesionari/Shoqeria Koncesionare dhe kërkesave për sqarime mbi keto raporte, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e projektit, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të tij.
- Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme, Koncesionari/Shoqeria Koncesionare do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

NENI 14

TARIFA E SHERBIMIT, TARIFA KONCESIONARE DHE MËNYRA E PAGESËS

- 14.1 Tarifat e Shërbimit për cdo verifikim të cdo aparati/instrumenti mates të shpërndarjes së karburantit ose gazit të lëngshëm do të jenë sipas sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave nr. 2 datë 08.02.2013. Në asnjë rast Tarifat e Sherbimit nuk mund të jene me te uleta se ato te parashikuara ne Udhëzimin e sipercituar, ne momentin e Hyrjes ne Fuqi te kesaj Kontrate. Tarifat e Sherbimit mund te ndryshohen vetem me propozim te arsyetuar te Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare.
- 14.2 Frekuenca e Verifikimit te Rregullt te Instrumentave Mates do të jetë jo me pak se dy herë në vit për çdo Subjekt.
- 14.3 Pas fillimit të kryerjes së Shërbimit, Palët mund të bien dakord për rritjen e frekuencës së Verifikimit te Rregullt te Instrumentave Mates, për një periudhë tranzitore, në rast se:
- a) Gjatë kryerjes së verifikimeve në terren rezulton se mbi 5% e totalit te instrumenteve mates të verifikuara rezultojnë me probleme; dhe/ose;
 - b) databazat, të dhënat dhe fletët e punës që do të dorëzohen nga Autoriteti Kontraktues sipas dispozitave të kësaj kontrate, përmbajnë pasaktësi ose janë të paplota.
- Rritja e frekuencës mund të bëhet për të gjithë Subjektet e Detyruara ose për zona ose

Subjekte te Detyruara të caktuara:

14.4 Koncesionari do të jetë përgjegjës për ofrimin e Shërbimit ndaj çdo Subjekti të Detyruar. Koncesionari do të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe administrimin e e të ardhurave që vijnë nga kryerja e këtij shërbimi. Fakturimi i Tarifave të Shërbimit do të kryhet në përputhje me kryerjen e Shërbimit. Çdo faturë për Shërbimin objekt të kësaj Kontrate, e leshuar nga Koncesionari përben titull ekzekutiv.

14.5 Nëse në çdo kohë, pas Datës Efektive Koncesionari pëson një rritje në kosto apo pakësim në rezultatin neto pas taksimit apo barrë të tjera, në masën mbi 5%, të justifikuar me dokumentacionin përkatës, përfshirë por pa u kufizuar kur rritja apo pakësimi vjen vetëm si pasojë e një ndryshimi në Ligjin e Zbatueshem, Koncesionari mund të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues dhe të propozojë shtesa/ndryshime të kësaj Kontrate me qëllim që Koncesionari, të vendoset në të njëjtën pozitë financiare siç do të kishte qenë nëse nuk do të kishte ndodhur ky ndryshim në Ligjin e Zbatueshem, që ka sjellë si rrjedhim rritje të kostove, pakësim në të ardhurat apo barrë tjetër financiare.

Autoriteti Kontraktues do të komunikojë me shkrim Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare qëndrimin e tij në lidhje me pranimin ose refuzimin e propozimit të Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare për ndryshim të Kontratës si rrjedhojë e ndryshimit në Ligjin e Zbatueshem, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e njoftimit të Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare. Palët bien dakord se Autoriteti nuk do të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme ndryshime të kësaj Kontrate të propozuara nga Koncesionari/Shoqeria Koncesionare, në mënyrë që Koncesionari/Shoqeria Koncesionare të ruajë pozitën financiare që gëzonte përpara ngjarjes.

14.6 Nëse në çdo kohë, pas Dates Efektive Koncesionari/Shoqeria Koncesionare pëson një pakësim në të ardhurat e tij sipas kësaj Kontrate, për rrjedhojë të rënies së numrit të inspektimeve me mbi 5%, që vjen vetëm si pasojë e ndryshimeve ligjore, Koncesionari/Shoqeria Koncesionare mund të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues dhe të propozojë shtesa/ndryshime të kësaj Kontrate me qëllim që Koncesionari/Shoqeria Koncesionare, të vendoset në të njëjtën pozitë financiare siç do të kishte qenë nëse nuk do të kishte ndodhur ky pakësim në numrin e verifikimeve si treguar në këtë paragraf. Në asnjë rast Autoriteti Kontraktues nuk do të refuzojë pa shkak të arsyeshem propozimin e Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare për ndryshim të Kontratës.

14.7 Nëse në çdo kohë, pas Dates Efektive Koncesionari/Shoqeria Koncesionare pëson një pakësim në të ardhurat për rrjedhojë të rënies së numrit të verifikimeve/inspektimeve, që nuk lidhet me ndryshime ligjore, që shkakton një zvogëlim të IRR së parashikuar në Modelin Financiar me më shumë se 2%, atëherë Koncesionari/Shoqeria Koncesionare mund të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues dhe të propozojë shtesa/ndryshime të kësaj Kontrate me qëllim që Koncesionari/Shoqeria Koncesionare, të vendoset në të njëjtën pozitë financiare siç do të kishte qenë nëse nuk do të kishte ndodhur ky pakësim në numrin e verifikimeve si treguar në këtë paragraf.

Palët bien dakord se Autoriteti Kontraktues nuk do të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme ndryshime të kësaj Kontrate të propozuara nga Koncesionari/Shoqeria Koncesionare, në mënyrë që Koncesionari/Shoqeria Koncesionare të ruajë pozitën financiare që gëzonte përpara ngjarjes.

14.8 Koncesionari/Shoqeria Koncesionare detyrohet të paguaje Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesioni të barabartë me 2.5 % të Të Ardhurave të realizuara, që Koncesionari/Shoqeria Koncesionare do të grumbullojë nga Tarifat e Shërbimit. bazuar në deklaratimet financiare të

kontrolluara/certifikuara të Shoqërisë Koncesionare siç rezulton nga Pasqyrat Financiare të po atij viti. Tarifa Koncesionare do të paguhet nga Koncesionari brenda 6 (gjashtë) muajve të parë të secilit vit kalendarik bazuar në Pasqyrat Financiare të audituara, që i përkasin vitit financiar paraardhës.

- 14.9 Tarifat e Koncesionit të papaguara (të prapambetura) në datën e përcaktuar do të paguhet pas kësaj date sëbashku me një interes prej 0.05% për çdo ditë vonesë llogaritur mbi pjesën e papaguar (prapambetur). Në rast se Koncesionari do të jetë në vonesë mbi 2 këste, ose një këst por në mënyrë të përsëritur, Autoriteti Kontraktues do të ketë të drejtë të paguhet për tarifën e prapambetura plus interesat përkatës nga shuma e Sigurimit të Kontratës.
- 14.10 Tarifat e Shërbimit referuar në pikën 14.1 do të indeksohen çdo vit duke përdorur normën e inflacionit të publikuar nga INSTAT.

NENI 15 VLERËSIMI I INVESTIMEVE

- 15.1 Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 70,000,000 (shtatëdhjetë milionë) lekë, sipas Shtojcës 3, duke i lejuar Koncesionarit ndryshimet përkatëse në raport me zërat e paraqitur në projektin e investimit.

NENI 16 PLANI I ZBATIMIT TE PROJEKTIT DHE RIINVESTIMI

- 16.1 Koncesionari merr përsipër të zbatojë planin e zbatimit të projektit sipas Shtojcës nr 5 bashkelidhur kësaj kontrate. Koncesionari do të fillojë kryerjen e Shërbimit jo më vonë se 9 (nëntë) muaj kalendarikë nga data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate.
- 16.2 Koncesionari merr përsipër të fillojë planin e zbatimit të projektit brenda 60 ditësh nga data e nënshkrimit të Kontratës.
- 16.3 Koncesionari merr përsipër të kryej të gjitha investimet për pajisje brenda 9 muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi. Afati për pajisjen me leje është jo më shumë se 18 muaj nga data e hyrjes në fuqi të Kontrates së Koncesionit të parashikuar në Dokumentat e koncesionit.
- 16.4 Këto afate do të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

NENI 17 VERIFIKIMI I PLANIT TË INVESTIMEVE

- 17.1 Në përfundim të planit të investimeve Autoriteti Kontraktues, duhet të kryej verifikimin e investimeve të kryera në raport me parashikimet në këtë Kontratë. Verifikimi do të fillojë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.

- 17.2 Ky verifikim do të kryhet nga një grup pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për kryerjen e investimeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga fillimi i verifikimit.
- 17.3 Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë këtij verifikimi, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë verifikimin. Koncesionari fillon ofrimin e Shërbimit 15 (pesëmbëdhjetë) dite kalendarike pas dorëzimit të raportit pranë Autoriteti Kontraktues.
- 17.4 Me njoftimin e datës së fillimit të shërbimeve Autoriteti Kontraktues garanton që ky shërbim do të ofrohet vetëm nga Koncesionari në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

NENI 18 SIGURIMET E NEVOJSHME

- 18.1 Koncesionari në çdo kohë do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare, dhe do t'i përcjellë, ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuara të çdo certifikatë sigurimi pas marrjes së një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 18.2 Koncesionari duhet të sigurojë ofrimin e shërbimit të objektit të kontratës gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 të Ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit, të ri sigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe ri sigurime" gjatë gjithë periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 18.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e kryerjes së shërbimit objekt të kontratës, vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer projektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruesi do të paguajë për kompensimin e dëmit do të përballohet nga Koncesionari.
- 18.4 Koncesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

NENI 19 RAPORTIMI

- 19.1 Koncesionari/Shoqeria Koncesionare është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e verifikimeve, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues. Në fund të çdo viti Koncesionari/Shoqeria Koncesionare do të dorëzojë një raport për periudhën 12 mujore të aktivitetit të tij.

NENI 20

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

20.1 Autoriteti Kontraktues do të ushtrojë të drejtat e parashikuara më poshtë:

- 20.1.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtën që të monitorojë, inspektojë, kontrollojë dhe mbikqyrë çdo fazë të zbatimit të Kontratës, nëpërmjet personave të autorizuar prej tij, me qëllim që të verifikojë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Koncesionit.
- 20.1.2 Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën që të ushtrojë mbikqyrjen e përgjithshme çdo 24 (njetzet e katër) muaj, gjatë zbatimit dhe funksionimit të Kontratës, në mënyrë që të verifikojë se kryerja e Shërbimit, cilësia dhe konformiteti i tyre janë në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate dhe me Projektin e paraqitur nga Konçesionari dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 20.1.3 Përveç sa parashikohet në paragrafin 20.1.2 me sipër, në rastet kur sipas informacioneve të arsyeshme dhe të besueshme Autoriteti Kontraktues është në dijeni të mospërmbushjes së detyrimeve të kësaj Kontrate, mund të ushtrojë monitorimin në çdo kohë, me njoftim paraprak prej të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike.
- 20.1.4 Në rast të shkeljes së kushteve të Kontratës së Koncesionit të konstatuara gjatë monitorimit dhe mbikqyrjes së përgjithshme, Konçesionari/Shoqeria Koncesionare do të njoftohet me shkrim në lidhje me masat që do të ndërmerren dhe detyrimet që duhet të përmbushen, si dhe në lidhje me mënyrën dhe kushtet e përmbushjes së tyre.

20.2 Autoriteti Kontraktues merr përsipër përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme:

- 20.2.1 Të ndërmarrë të gjitha hapat dhe të bëjë të gjitha përpjekjet që të përmbushë brenda afateve të arsyeshme dhe pa vonesa veprimet e përcaktuara në këtë Kontratë.
- 20.2.2 Të garantojë vazhdimësinë e zbatimit të Kontratës së Koncesionit, pavarësisht nga ndryshimet e objektivave apo të legjislacionit në Shqipëri në lidhje me sektorin ku vepron Koncesionari.
- 20.2.3 Të asistojë Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare (kur është e zbatueshme) në raportet me organet e administratës shtetërore, qendrore dhe lokale dhe entitetet private, në lidhje me çdo pengesë që mund të haset gjatë procedurave të lëshimit të lejeve, licencave, autorizimeve, akreditimeve ose çdo lloj tjetër dokumenti i cili është i nevojshëm për zbatimin e objektit të Koncesionit, brenda përcaktimeve të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 20.2.4 Të materializojë, përmes udhëzimeve apo akteve të tjera normative, për të siguruar që të gjitha organet e administratës shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre në lidhje me Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare, të jenë të informuara në mënyrën e duhur në lidhje me ekzistencën e kësaj Kontrate dhe që të bashkëpunojnë pa vonesa të paarsyeshme, me Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare për të mundësuar kryerjen e Shërbimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në aksesin e

- Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare në të gjithë Pikat brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- 20.2.5 Të angazhohet dhe materializojë bazuar në legjislacionin e zbatueshem për të mundësuar aksesin e lirë të Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare në të gjitha Pikat. Ky akses është vendimtar për aftësinë e Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare për të realizuar detyrimet e marra përsipër prej tij në Kontratën e Koncesionit. Palët bien dakord që mospasja e Aksesit nga ana e Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare në Pikat përkatëse përbën shkak për kompensimin e këtij të fundit.
- 20.2.6 Të ndihmojë Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare, kur i kërkohet, në zhvillimin e Projektit dhe në përgjithësi në zbatimin e kësaj Kontrate. Veçanërisht Autoriteti Kontraktues do të sigurojë dhe do të mundësojë kur është e nevojshme, hyrjen e Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare në të gjitha Pikat e karburanteve edhe gazit të lëngshëm. Autoriteti Kontraktues do të garantojë gjithashtu sigurinë e kryerjes së Shërbimeve të Kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të kryera nga Koncesionari/Shoqeria Koncesionare me anë të stafit të tij.
- 20.2.7 Autoriteti Kontraktues angazhohet, brenda një afati 12 muaj nga nënshkrimi i Kontratës, se do të propozojë të gjitha ndryshimet e nevojshme për përshtatjen e kuadrit ligjor dhe nënligjor përkatës dhe do të marrë iniciativën për miratimin e të gjitha ligjeve, akteve nënligjore dhe/ose rregulloreve që të lejojnë Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare të kryejë shërbimin objekt të Kontratës përfshirë këtu veprimtarinë e verifikimit metrologjik sipas legjislacionit të zbatueshëm shqiptar mbi metrologjinë, përfshirë por pa u kufizuar të drejtën e Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare për të evidentuar, raportuar, pezulluar dhe/ose bllokuar subjektet në shkelje. Autoriteti Kontraktues angazhohet të draftojë dhe implementojë cdo rregullore dhe/ose udhëzim perkates me qëllim krijimin e nje *Task Force*, vetëm kur kërkohet nga Koncesionari, përgjegjëse për të mundësuar Gezimin e Qetë, duke përfshirë por pa u kufizuar lejimin e aksesit në të gjithë Pikat e territorit të Republikës së Shqipërisë. Në cdo rast mos-lejimi i kryerjes së Shërbimit (verifikimi ligjor i instrumentave matës, pezullimin / bllokimin të instrumentit matës, moskorigjimi / riparimi brenda periudhës perkatese kohore, kontroll për demtime të elementeve pezulluese/bllokues/njoftues) perben shkak për pezullim dhe revokim license sipas rastit për stacionet e shitjes së karburanteve që ushtrojnë veprimtarinë tregtare në lidhje me karburantet dhe gazin e lëngshëm nëpërmjet instrumenteve matëse.
- 20.2.8 Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha dëmet e shkaktuara Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare për shkak të shkeljes së Kushteve të përcaktuara në Kontratën e Koncesionit.
- 20.2.9 Në qoftë se është vendosur me vendim të formës së prerë nga gjykata ose nga një gjykatë arbitrazhi, titull ekzekutiv në kuptim të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, Autoriteti Kontraktues duhet të përballojë shpenzimet që lidhen me dëmet e shkaktuara, si pasojë e veprimeve direkte apo indirekte të tij, të kryera me faj. Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pa dëmtuar Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare;

NENI 21 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

- 21.1 Konçesionari/Shoqeria Koncesionare, gjatë zbatimit të Konçesionit, do të ushtrojë të drejtat e mëposhtme:
- 21.1.1 Të kërkojë nga Autoriteti Kontraktues që të garantojë respektimin e plotë, edhe nga palët e treta, të të drejtave dhe kompetencave që i janë dhënë Konçesionarit/Shoqerise Koncesionare me anë të kësaj Kontrate;
 - 21.1.2 Të kërkojë nga Autoriteti Kontraktues garantimin e rendit publik dhe zbatimin në kushte sigurie të Shërbimit Kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, duke përfshirë por pa u kufizuar në aksesin në të gjitha Pikat e karburanteve edhe gazit të lëngshëm.
 - 21.1.3 Të kërkojë, përmbushjen e detyrimeve të Autoritetit Kontraktues në çdo rast, kur ky i fundit nuk i përmbush ato plotësisht ose vonon përmbushjen e tyre.
 - 21.1.4 Për aq sa është e zbatueshme, Konçesionari/Shoqeria Koncesionare duhet të pajiset nga Autoriteti Kontraktues me të gjitha lejet, licencat, akreditimet dhe autorizimet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate dhe për realizimin e objektit të Konçesionit. Për të gjitha rastet kur Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetence të lëshojë leje, licenca, akreditime ose autorizime, Koncesionari /Shoqeria Koncesionare ka të drejtë të kërkojë asistencën e Autoritetit Kontraktues për marrjen e tyre.
 - 21.1.5 Të aksesojë të gjithë Pikat e kaburantit dhe gazit të lëngshëm pa nevojë lajmërimi paraprak ndaj Subjektit të Detyruar.
 - 21.1.6 Të kryejë inspektime/verifikime shtesë të Subjektet e Detyruara, jashtë frekuencës së zakonshme së rënë dakord me Autoritetin Kontraktues, pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktues apo Subjektit të Detyruar që do të inspektohet. Koncesionari/Shoqeria Koncesionare nuk do të ketë të drejtë të tarifojë Subjektin e Detyruar për të këto inspektime shtesë. Gjithashtu Koncesionari ka të drejtë të bëjë kontrole rutinë për tu siguruar që shpërndarësit e karburantit dhe gazit të lëngshëm që kanë rezultuar me probleme dhe nuk janë riparuar, nuk janë në përdorim.
 - 21.1.7 Bllokimin e menjehershëm të instrumentit matës në rastet e mosplotësisht të kërkesave teknike dhe metrologjike ligjore dhe/ose vendosjen e një shiriti dhe/ose shenje tjetër dalluese, me efekt njoftimin e qytetarëve, që shpërdaresi përkatës pas verifikimit ka rezultuar me probleme dhe që nuk duhet të përdoret më nga Subjekti i Detyruar, deri në heqjen e shiritit dhe/ose shenjave të tjera dalluese nga Koncesionari/Shoqeria Koncesionare, që do të bëhet pas riparimit të shpërdaresit dhe kryerjes së verifikimit pas riparimit.
 - 21.1.8 Në rastet kur nga verifikimi rezulton që instrumenti matës ligjor i kontrollueshëm nuk plotëson kërkesat teknike/metrologjike, Koncesionari/Shoqeria Koncesionare njofton Autoritetin Kontraktues.
 - 21.1.9 Të publikojë në faqen e internetit të Shoqerise Koncesionare emrat e pikave të kaburantit të cilat:
 - a) nuk kanë kryer pagesën dhe rrjedhimisht nuk janë verifikuar;
 - b) kanë hequr shiritin dhe/ose shenja të tjera dalluese/njoftuese, të përmendura të paragrafi 21.1.7;
 - c) rezultojnë se e kanë në përdorim instrumentin matës ku janë identifikuar probleme teknike/metrologjike.
 - 21.1.10 Në rast të shkeljeve të parashikuara në nenin 21.1.9, pika b. Koncesionarit/Shoqeria Koncesionare i lind e drejta që të dorëzojë denoncimin në organet kompetente.

21.1.11 Konçesionari/Shoqeria Konçesionare nuk mban përgjegjësi për humbjen e xhiros që mund t'i shkaktohet Subjektit të Detyruar gjatë procesit të kryerjes së verifikimit, përfshirë këtu dhe verifikimet shtesë sipas pikës 21.1.6, as për humbjen e xhiros që mund të shkaktohet nga bllokimi apo vendosja e elementeve njoftues.

21.2 Konçesionari/Shoqeria Konçesionare merr përsipër përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme:

21.2.1 Detyrimet e përgjithshme të Konçesionarit/Shoqeria Konçesionare:

- a) Të zbatojë Konçesionin në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe të Shtojcave të saj;
- b) Të kryejë të gjitha shërbimet objekt të Konçesionit dhe të përmbushë detyrimet e tij në përputhje me këtë Kontratë. Dokumentat e procedurës konkurruese, Ofertën Teknike, Ofertën Financiare, Projektin dhe në përgjithësi duke bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme, në mënyrë efçente dhe ekonomike dhe në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale më të mira;
- c) Të ndjekë praktika të shëndosha biznesi, të përdorë teknologjinë e ofruar prej tij në Ofertën Teknike dhe në Projekt, si dhe të zbatojë metoda të sigurta pune;
- d) Të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e nënkontraktorëve (sipas kontratave përkatëse që mund të jenë të nevojshme) në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe të Shtojcave të saj;
- e) Pas përfundimit të kohëzgjatjes së Konçesionit, asetet e krijuara, të reja apo të rikonstruara gjatë periudhës së Konçesionit, në funksion të këtij Konçesionit, së bashku me sistemet hardware dhe software do ti transferohen Autoritetit Kontraktues pa shpërblim. Palët bien dakord, për të shmangur cdo lloj keqkuptimi, që asetet e krijuara, në kuptim të fjalisë pararendëse, do të kufizohen vetëm në ato asete që ka krijuar Shoqëria Konçesionare në funksion të këtij Konçesionit, dhe në mënyrë eksplicite përjashton asetet që do të krijojë Konçesionari gjatë kësaj periudhe.
- f) Konçesionari/Shoqeria Konçesionare duhet të respektojë dhe të zbatojë legjisllacionin shqiptar në fuqi;

21.2.2 Detyrimet e veçanta të Konçesionarit:

- a) Konçesionari/Shoqeria Konçesionare duhet të realizojë kryerjen e Shërbimit të Kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm objekt i Konçesionit si dhe duhet të kryejë investimet sipas planit të investimeve, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 5 të kësaj Kontrate.
- b) Konçesionari/Shoqeria Konçesionare do t'i raportojë mbi bazë tre mujore Autoritetit Kontraktues ose personave të autorizuar prej tij, mbi progresin në Fazën e Zbatimit të Projektit;
- c) Konçesionari/Shoqeria Konçesionare do të njoftojë Autoritetit Kontraktues brenda 30 ditëve nga Hyrja në Fuqi e Kontrates për formimin e Shoqërisë Konçesionare, e cila do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Republikën e Shqipërisë. Një kopje e ekstraktit, që verteton themelimin e Shoqërisë Konçesionare, me dokumentet shoqeruese të Shoqërisë Konçesionare, do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Në mënyrë të veçantë, kërkohet që në përmbajtjen e statutit të Shoqërisë Konçesionare të jetë përfshirë pikat si më poshtë vijon:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri aksionare”, dhe do të funksionojë në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
 - ii. Objekti i shoqërisë: Shoqëria Koncesionare do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj hartimin e Projektit përfundimtar, projektimi, vënia në punë e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm ofrimin e shërbimit të kërkuar dhe transferimin e pajisjeve të Sistemit Operativ tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të afatit të Koncesionit;
 - iii. Kohëzgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar, me kushtin që gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, të kryejë ekskluzivisht aktivitetet tregtar në përputhje me objektin e kësaj Kontrate;
 - iv. Themeluesit e shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet vetëm nga Koncesionari si palë e kësaj Kontrate Koncesioni.
- d) Me krijimin e Shoqërisë Koncesionare, të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me këtë Kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare, përveç të drejtave dhe detyrimeve që i përkasin periudhës përpara themelimit të saj si dhe së bashku me të drejtat dhe detyrimet specifike të cilat i mbeten në ngarkim të shoqërisë ofertuese, sipas kësaj Kontrate. Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare e krijuar, do të jenë solidarisht përgjegjës për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Kontratë.
 - e) Në qoftë se është vendosur me vendim të formës së prerë nga gjykata ose nga një gjykatë arbitrazhi, titull ekzekutiv në kuptim të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, Koncesionari duhet të përballojë shpenzimet që lidhen me dëmet e shkaktuara, si pasojë e veprimeve direkte apo indirekte të tij, të kryera me faj. Koncesionari do të mbajë të pa dëmtuar Autoritetin Kontraktues;
 - f) Koncesionari/Shoqëria Koncesionare duhet të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në zbatimin e Koncesionit;
 - g) Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, në përputhje me Shtojcën 5 është i detyruar të sigurojë cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të shërbimit gjatë periudhës së Koncesionit;
 - h) Koncesionari/Shoqëria Koncesionare duhet të marrë të gjitha masat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, për të garantuar respektimin e parashikimeve të legjislacionit shqiptar mbi punësimin, sigurinë, disiplinën teknike, kushtet e sigurimit në punë, higjienën dhe mbrojtjen nga zjarri, trajnimin e personelit, në mënyrë që të parandalojë çdo dëm apo aksident në punë ashtu si dhe të shmangë dëmet ndaj mjedisit, pronës publike dhe private;
 - i) Koncesionari/Shoqëria Koncesionare duhet të përballojë shpenzimet e finalizimi së kësaj kontrate;
 - j) Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do të realizojë trajnime të vazhdueshme për të gjithë personelin e Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare, i cili është punësuar apo angazhuar në kryerjen e Shërbimit të Kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm;
 - k) Përveçse nëse pranohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues ose përcaktohet ndryshe në këtë Kontratë, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do të përdorë asetet e këtij projekti vetëm për ofrimin e Shërbimeve ndaj Autoritetit

Kontraktues dhe nuk do ta përdorë atë për qëllimet personale të Konçesionarit ose për t'i ofruar Shërbime të tjera palëve të treta.

- l) Përveçse nëse shprehet ndryshe në këtë Kontratë, humbja ose shkatërrimi i ndonjë aseti të Konçesionarit/Shoqërisë Koncesionare në vendndodhjen e tij, nuk do të shkarkojë Konçesionarin/Shoqërinë Koncesionare nga detyrimet e tij për të ofruar Shërbime në përputhje me Kontratën.
- m) Të marrë të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- n) Të realizojë investimet e parashikuara sipas afateve të përcaktuar dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
- o) Të zbatojë projektin për vënien në punë të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm.
- p) Të ketë në çdo kohë në gatishmëri, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga kontrata në përputhje me specifikimet teknike dhe ofertën e paraqitur në tender. Në rast se përdorimi i një pjese të mjeteve dhe pajisjeve është i pamundur për shkaqe teknike për zona ose pika të caktuara, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të ndryshojë një pjesë të mjeteve dhe pajisjeve me mjete dhe pajisje analoge.
- q) Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit
- r) Të parandalojë dhe kontrollojë çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga ndonjë punim i tij dhe të kthejë ambientin, me shpenzimet e veta, në situatën e mëparshme (para ndotjes).
- s) Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet e shkaktuara nga Shoqëria Koncesionare ndaj Autoritetit Kontraktues apo palëve të treta.
- t) Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
- u) Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;

KREU 2 NGJARJE TË VEÇANTA

Neni 22

SHKAK KOMPENSIMI

22.1 Në rast se, si rrjedhojë e një Shkaku Kompensimi:

- a) Shoqëria Koncesionare vonohet në kryerjen e investimeve /apo të fazës së shërbimit sipas planit të investimit sipas shtojces 5 pjesë e kësaj kontrate. ose
- b) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tjera të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; ose
- c) Shoqërisë Koncesionare i kanë lindur ose do t'i lindin kosto që nuk do t'i kishin lindur, apo nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura që ndryshe do të ishin gjeneruar, po të mos kish ndodhur një Shkak i tillë Kompensimi.

Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të kërkojë një, disa nga ose të gjitha përfitimet e mëposhtme të aplikueshme sipas rastit, në formën e:

- i) Një shtyrjeje të datës së programuar të përfundimit paraprak të investimeve /ose fillimit të shërbimeve për vonesën e pësuar nga Shoqëria Koncesionare sipas programit të saj;
- ii) Përjashtimit nga përmbushja e detyrimeve të saj për aq dhe në masën sa ato janë prekur nga ndodhja e Shkakut të Kompensimit;
- iii) Të drejtës për kompensim; dhe/ose
- iv) Mosaplikimit të dispozitave për zgjidhjen e Kontratës për Mospërmbushjen e Detyrimeve të Koncesionarit /Shoqërisë Koncesionare për aq sa Shkaku i Kompensimit ka shkaktuar mospërmbushjen ose ka kontribuar materialisht për të.

22.2 Kur vonesa në zbatimin e afateve të poshtëpërmendura të njoftimit nuk është shkaktuar nga Koncesionari ose është shkaktuar për arsye që nuk varen nga Koncesionari. Shoqëria Koncesionare siguron përfitime sipas Nenit 22.1 më sipër, në rrethana kur ka njoftuar Autoritetin Kontraktues për kërkesën e saj për të marrë ndonjë prej këtyre përfitimeve pa vonesa të tepërta, por gjithsesi, jo më vonë se maksimumi:

- 22.2.1 30 (tridhjetë) Ditë kalendarike pasi Shoqëria Koncesionare ka marrë dijëni për ndodhjen e Shkakut të Kompensimit; dhe
- 22.2.2 jo më vonë se 30 (tridhjetë) Ditë kalendarike pas dorëzimit të njoftimit të përmendur në paragrafin 22.2.1 më sipër:

- a) I ka dhënë Autoritetit Kontraktues një shpjegim të plotë dhe të hollësishëm për Shkakun e Kompensimit dhe përfitimet e kërkuara;
- b) Në rastin e një vonese, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues për kohëzgjatjen e përafërt të kësaj vonese;
- c) E ka vënë në dijeni Autoritetin Kontraktues për çdo informacion tjetër përkatës, që lidhet me Shkakun e Kompensimit; dhe
- d) E ka njoftuar Autoritetin Kontraktues për humbjen e pritshme të të ardhurave, ose për një rritje të kostove që rezultojnë nga një Shkak Kompensimi,

me kusht që, në rast se informacioni i plotë nuk është i disponueshem brenda 30 (tridhjetë) Ditësh kalendarike nga dhënia e njoftimit sipas Nenit 22.2.1, Shoqëria Koncesionare të dërgojë një njoftim ku të parashtrijë të gjithë informacionin e disponueshem dhe pas paraqitjes të këtij njoftimi t'u japë informacion të mëtejshëm Autoritetit Kontraktues; dhe

22.2.3 T'i ketë provuar Autoritetit se:

- a) Shkaku i Kompensimit ka rezultuar ose do të rezultojë në shtyrjen e planit, mospërmbushjen e detyrimeve të tjera të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare, shtimin e kostove, ose mos gjenerimin e të ardhurave nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare; dhe
- b) Koncesionari/Shoqëria Koncesionare i ka bërë të gjitha përpjekjet, nëse Shkaku i Kompensimit linte mundësi të arsyeshme për përpjekje nga ana e Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare, që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, për të parandaluar apo zbutur pasojat e një Shkaku Kompensim. Për shmangien e çdo dyshimi, përfitimi i pretenduar i korrespondon vetëm pasojave të Shkakut të Kompensimit, e cila nuk mund të ishte parandaluar apo zbutur nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare me anë të bërjes së përpjekjeve të tilla të arsyeshme.

22.2.4 Nëse Shoqëria Koncesionare i ka përmbushur detyrimet e parashikuara në Nenin

22.2 dhe ka deklaruar se ka ndodhur një Shkak Kompensimi dhe mbasi është vlerësuar se Shoqëria Koncesionare i duhet hequr përkatësisht përgjegjësia për mospërbushjen e detyrimit të saj, në përputhje me Nenin 22, k. atëherë:

- a) Kur është e përshtatshme, data e programuar e përfundimit të investimeve ose e fillimit të shërbimeve shtyhet për një periudhë kohe të përcaktuar nga dhe rënë dakord mes paleve, por gjithsesi jo më të shkurtër sesa periudha e vonësës e shkaktuar nga Shkaku i Kompensimit; dhe/ose
- b) Nëse Shoqëria Koncesionare i ka bërë, ose do të bëjë shpenzime shtesë, ose ka pësuar ose do të pësojë humbje të të ardhurave, që ndryshe nuk do t'i kishte bërë/do t'i kishte gjeneruar, po të mos kish ndodhur një Shkak i tillë Kompensimi. Autoriteti Kontraktues e rimbursion Shoqërinë Koncesionare për shpenzime të tilla dhe/ose humbje të të ardhurave, me qëllim që kthejë Shoqërinë Koncesionare në një gjendje që nuk është as më e mirë as më e keqe se më parë. Shuma e një rimbursimi të tillë do të përcaktohet, për aq sa është e mundur, me anë të përdorimit të Modelit Financiar, ose situacioneve faktike; dhe/ose
- c) Autoriteti Kontraktues nuk e ushtron të drejtën e tij të Përfundimit të Parakohshëm të Kontratës për shkak të Mospërbushjeve nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare të detyrimeve të tij, shkaktuar nga Shkaku i Kompensimit; dhe/ose
- d) Autoriteti Kontraktues i ofron Shoqërisë Koncesionare mundësinë e përjashtimit nga detyrimet e tij, që rrjedhin nga kjo Kontratë, të cilat përcaktohen dhe dakortësohen mes paleve.

me kusht që, nëse Shoqëria Koncesionare ose Autoriteti Kontraktues nuk bien dakord në përputhje me këtë nen, çdo mosmarrëveshje të vendoset në përputhje me dispozitat e kesaj kontrate.

- 22.3 Përveçse sipas parashikimeve të Nenit 22.2, nëse Shoqëria Koncesionare nuk i jep Autoritetit Kontraktues informacionin deri në njërin nga afatet e parashikuara, ai nuk merr asnjë nga përfitimet e lartpërmendura si rezultat i Shkakut të Kompensimit. Për të shmangur çdo dyshim, Palët bien dakord që edhe në rastin kur Koncesionari/Shoqëria Koncesionare nuk paraqet kerkesën për kompensim brenda afatave, Autoriteti Kontraktues nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij të Përfundimit të Parakohshëm të Kontratës.
- 22.4 Shoqëria Koncesionare është e detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktues në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër dhe/ose material në lidhje me një Shkak Kompensimi, si dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktues për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.

Neni 23
SHKAQE LEHTËSIMI

23.1 Kur si rrjedhojë e një Shkaku Lehtësimi:

23.1.1 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë planin e investimeve me qëllim që të mund të sigurojë njoftimin për fillimin e kryerjes së shërbimit, deri në datën e programuar të përfundimit ; ose

23.1.2 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjërin prej detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; atëherë

Shoqëria Koncesionare mund të sigurojë përfitimet e mëposhtme të aplikueshme sipas rastit, në formën e:

i) Shtyrjes të datës së programuar të përfundimit, që i përshtatet vonesës së shkaktuar Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare në bazë të Programit të tij; dhe/ose

ii) Lehtësimit nga detyrimet e tij ose shtyrja e zbatimit të tyre, për aq dhe deri në masën sa ato janë prekur nga ndodhja e Shkakut Lehtësues: dhe/ose

iii) Pas njoftimit të fillimit të shërbimeve, në rastin e një Shkakut Lehtësues si rezultat i të cilit Koncesionari/Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë të gjitha ose një pjesë materiale të detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, për një periudhë më shumë se 2 (dy) muaj, ose për shkak të ndonjë arsyeje tjetër të vlefshme, e cila, ka shkaktuar një vonesë prej më shumë se 3 (tre) Muajsh (periudhë e cila përfshin çdo Shkak Lehtësues që ndodh përpara njoftimit të fillimit të shërbimeve, përfiton mos-aplikimin e dispozitave për zgjidhjen e Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve nga Shoqëria Koncesionare të detyrimeve të saj për aq sa Mospërmbushja nga Shoqëria Koncesionare e detyrimeve ka ardhur si rrjedhojë e një Shkakut Lehtësues.

23.2 Përveçse kur vonesa në zbatimin e afateve të poshtëpërmendura të njoftimit nuk është shkaktuar nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare ose është shkaktuar për arsye që nuk varen nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare i siguron përfitime të tilla vetëm në rrethanat kur ai:

23.2.1 E ka njoftuar Autoritetin Kontraktues për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesë, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi 30 (tridhjetë) Ditë kalendarike pasi Koncesionari/Shoqëria Koncesionare ka marrë dijëni për ndodhjen e Shkakut të Lehtësimit; dhe i ka dhënë Autoritetit Kontraktues një shpjegim të plotë rreth Shkakut Lehtësues dhe përfitimeve të kërkuara;

Në rastin e një vonese të shkaktuar nga Shkakut i Lehtësimit, e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues për kohëzgjatjen e vlerësuar të një vonese të tillë;

23.3 Nëse Shoqëria Koncesionare i ka kryer detyrimet e parashikuara në Nenin 23.2, atëherë:

a) Sipas rastit, data përkatëse e programuar për përfundimin përkatës shtyhet me një periudhë kohe që përcaktohet nga Palet, por gjithsesi jo më të shkurtër sesa periudha e vonesës së shkaktuar nga Shkakut i Lehtësimit; dhe

b) Autoriteti Kontraktues nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij për përfundimin e parakohshëm të Kontratës për shkak të Mospërmbushjeve të Detyrimeve nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, në lidhje me një shkelje të detyrimeve të

- tij sipas kësaj Kontrate, shkaktuar nga Shkaku Lehtësues; dhe
- c) Autoriteti Kontraktues e përjashton Shoqërinë Koncesionare nga detyrimet e saj, që rrjedhin nga kjo Kontratë, të cilat përcaktohen nga pala.
- 23.4 Përveçse sipas parashikimeve të Nenit 22.2, në rast se Shoqëria Koncesionare nuk u jep informacion Autoritetit Kontraktues deri në njërin nga afatet e parashikuara në këtë nen, ai nuk do të marrë asnjë nga përfitimet e mësipërme që rrjedhin nga Shkaku i Lehtësimit, derisa të dërgojë një informacion të tillë brenda afatit të përcaktuar në Nenin 23.2.
- 23.5 Shoqëria Koncesionare është e detyruar të njoftojë Autoritetin Kontraktues pa vonesa të pajustificuara në rast se merr dijeni për ndonjë informacion tjetër material në lidhje me një Shkak të parashikuar Lehtësues si dhe të njoftojë Autoritetin Kontraktues për hollësitë e një informacioni të tillë, të cilat janë të reja ose që tregojnë se informacioni i dhënë më parë ka qenë materialisht i pasaktë dhe/ose i gabuar.
- 23.6 Në rastin kur një Shkak Lehtësimi, ose pasojat e tij vazhdojnë të mbeten të tilla që:
- a) Në varësi të nenit 23, vonesa në njoftimin e fillimit të shërbimeve kalon 6 (gjashtë) Muaj; ose
- b) Në varësi të nenit 23 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë të gjithë ose një pjesë materiale të detyrimeve të saj, që rrjedhin nga kjo Kontratë, për një periudhë që i kalon 6 (gjashtë) Muaj,
Të dyja Palët do të takohen për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme, që ka të bëjë me të tilla Shkaqe të zgjatura Lehtësimi.

NENI 24 NGJARJE TË FORCËS MADHORE

- 24.1 Forca madhore nënkupton çdo rrethanë që në mënyrë të arsyeshme dhe objektive është absolutisht tej parashikimit dhe kontrollit, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të palës së cënuar që rezulton ose shkakton pamundësi të plotë ose të pjesshme të palës së cënuar për të përmbushur ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate (përveç kryerjes së pagesave të parave), por vetëm nëse dhe në masën që:
- a. kjo rrethanë në mënyrë objektive dhe absolute, nuk mund të parandalohet apo nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohej nga pala e cënuar;
- b. pala e cënuar ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmange pasojën e këtij rasti në aftësinë e palës së cënuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;
- c. ngjarja nuk është ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga pala e cënuar të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj kontrate, dhe
- d. pala e cënuar t'i ketë dhënë njoftim në afatin e rënë dakord palës tjetër (pala e pacënuar)
- 24.2 Konsiderohen Ngjarje të Forcës Madhore:
- Katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to;
 - Lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, bllokada, embargo- që zgjasin për një kohë jo më të vogël se gjashtë muaj;
- 24.3 Asnjë Palë nuk ka të drejtë të bëjë një padi ndaj Palës tjetër për shkelje të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore dhe në masën që një Ngjarje e Forcës Madhore e pengon të kryejë detyrimet e veta.
- 24.4 Kur ndodh një Ngjarje e një Force Madhore, Pala e Prekur e njofton Palën tjetër pa vonesa

- të arsyeshme. Njoftimi përfshin hollësitë për ndikimin e kësaj ngjarjeje në detyrimet e Palës së Prekur dhe për çdo veprim të propozuar për zbutjen e pasojave të saj.
- 24.5 Pa vonesa të arsyeshme, pas një njoftimi të tillë Palët konsultohen me njëra tjetrën me mirëbesim dhe bëjnë përpjekje të arsyeshme për të rënë dakord për kushtet e përshtatshme për zbutjen e efekteve të Ngjarjes së shkaktuar nga Forca Madhore dhe për të lehtësuar realizimin në vijimësi të Kontratës.
- 24.6 Kur Palët nuk bien dakord për kushte të tilla brenda 6 (gjashtë) Muajsh nga data e fillimit të Ngjarjes së shkaktuar nga Forca Madhore, dhe një forcë e tillë madhore vazhdon, ose pasojat e saj vazhdojnë të jenë të tilla saqë Pala e Prekur nuk është në gjendje t'i përmbushë të gjitha, ose pjesën më të madhe të detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate, Koncesionari mund ta zgjidhë këtë Kontratë, duke i dhënë një njoftim paraprak 30 (tridhjetë) ditë përpara Palës tjetër ("Njoftim për Përfundimin e Kontratës për Shkak të Ngjarjeve të Forcës Madhore").
- 24.7 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga një Forcë Madhore:
- a) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë shërbimet sipas afateve të parashikuara në Projekt; ose
 - b) Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tjera të saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; atëherë

Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të marrë një përfitim në formën e:

- i) Një shtyrjeje të datës së programuar të fillimit të shërbimeve, në përputhje me vonesën e pësuar nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare sipas Programit të tij;
 - ii) Përrjashtimin nga detyrimet e saj për aq sa ato preken nga Ngjarja e Forcës Madhore;
 - iii) Përrjashtim nga zgjidhja e Kontratës për faj të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare për aq sa mospërmbushja është shkaktuar ose është ndikuar materialisht nga ekzistenca e Ngjarjes së Forcës Madhore.
- 24.8 Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund të pretendojë përfitime të tilla vetëm në rrethana kur e ka njoftuar Autoritetin Kontraktues për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesa të arsyeshme, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:
- i) 10 (dhjetë) Ditë Pune pasi Koncesionari/Shoqëria Koncesionare ka marrë dijeni për ndodhjen e një Ngjarjeje të Forcës Madhore; ose
 - ii) 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas ngjarjes së shkaktuar nga Ngjarja e Forcës Madhore;
- 24.9 Nëse si rezultat i një Ngjarjeje të shkaktuar nga një Forcë Madhore Autoriteti Kontraktues nuk është në gjendje të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij që rrjedhin nga kjo Kontratë, atëherë Autoriteti Kontraktues mund të marrë një përfitim në formën e:
- a) Përrjashtimit nga detyrimet e tij për aq sa ato preken nga Ngjarja e Forcës Madhore;
 - b) Autoriteti Kontraktues mund të pretendojë përfitime të tilla vetëm në rrethana kur e ka njoftuar Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare për kërkesën e tij për t'i dhënë ndonjë nga këto përfitime pa vonesa të tepërta, por gjithsesi jo më vonë se maksimumi:
 - i) 10 (dhjetë) Ditë kalendarike pasi Koncesionari/Shoqëria Koncesionare ka marrë dijeni për ndodhjen e një Ngjarjeje të Forcës Madhore; ose
 - ii) 30 (tridhjetë) Ditë Pune pas ngjarjes së shkaktuar nga Ngjarja e Forcës Madhore.

24.10 Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar

- 24.10.1 Një "Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar" nënkupton rastet kur Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Autoritet Përrkatës tjetër vendor apo qendror, pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate merr apo dështon të ndërmarrë ndonjë

veprim të çdo natyre, ose nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate ose në përputhje me Ligjin (përveç veprimeve apo mosveprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues për të zbutur efektet e shkeljes nga ana e Shoqërisë Koncesionare), efekti i të cilave ndikon direkt ose indirekt mbi Shoqërinë Koncesionare dhe/ose provokon në mënyrë direkte ose indirekte ndonjë ndryshim të pafavorshëm aktual ose të mundshëm për Shoqërinë Koncesionare në shpenzimet apo të ardhurat (përfshirë por pa u kufizuar në to, Tatimet apo Taksat), apo pozicionin ekonomik dhe financiar të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to dhe/ose:

- a) mos kryerjen nga ana e Autoritetit Kontraktues apo ndonjë Autoriteti Përkatës tjetër, të ndonjë detyre ligjërish të detyrueshme për to, ose të ekzekutojë ose të zbatojë ndonjë të drejtë ligjore të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare: dhe/ose
- b) veprimet apo mosveprimet e Autoritetit Kontraktues apo ndonjë autoriteti tjetër shtetëror, të cilat, në tërësinë e tyre, tregojnë mungesën e vullnetit të autoritetit për të përmbushur këtë kontratë, apo për të krijuar rrethana që do të çonin në shkeljen e detyrimeve kontraktore nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare.
- c) një Ndryshim në Ligj i cili, pas zbatimit të dispozitave mbi Ndryshimin e Ligjit në përputhje këtë Kontratë, ende ndikon negativisht në aftësinë e Shoqërisë Koncesionare për të ndërmarrë, kryer dhe përfunduar projektin, si dhe zbatimin në tërësi të kësaj Kontrate.

Përveç kur një ngjarje mund të parandalohet apo të kapërcehet nga Pala e prekur nëpërmjet ushtrimit të vëmendjes dhe kujdesit të arsyeshëm, siç do të ushtrohet nga një person i matur në rrethana të ngjashme.

24.10.2 Nëse ndodh ndonjë Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar, Shoqëria Koncesionare do të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues duke dhënë hollësitë e arsyeshme të këtij veprimi dhe pasojat e tij të mundshme ekonomike për Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare. Autoriteti Kontraktues do të ketë një afat prej jo më shumë se 45 (dyzet e pesë) Ditë Pune, nga data e marrjes së këtij njoftimi me shkrim, për të bërë çdo përpjekje të mundshme për të ndrequr situatën, e cila rikthen gjendjen e përgjithshme ekonomike të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare në atë, në të cilën do të ishte, nëse ky Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk do të ndikojë në ndreqjen e tij brenda këtij afati, Palët do të konsultohen brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh kalendarike pas skadimit të kësaj periudhe me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të përbashkët, të pranueshme për situatën.

24.10.3 Në rast se një zgjidhje reciprokisht e kënaqshme e situatës nuk është arritur në kuadër të kësaj periudhe 14 (katërmëdhjetë) ditore kalendarike nëpërmjet:

- a) një rregullimi apo përshtatje të nevojshme, apo pagesë dhe/ose zgjatje afati, që mund të jetë e drejtë dhe e arsyeshme duke marrë në konsideratë rrethanat: dhe/ose
- b) një lehtësimi monetar të drejtë dhe të arsyeshëm sipas rrethanave: dhe/ose
- c) një shtyrje të Periudhës së Koncesionit, atëherë, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mundet që (i) të vazhdojë zbatimin e detyrimeve të tij në bazë të Kontratës duke e konsideruar Veprimin Material të Pafavorshëm Qeveritar si Shkak Kompensimi, ose (ii) të ndërpresë

Kontratën në përputhje me klauzolën për zgjidhjen e parakohshme të Kontratës për Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues, pa asnjë përgjegjësi apo dëm, apo kosto për Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare, në rast se çdo mjet juridik tjetër i parashikuar në këtë Kontratë nuk do të jetë i mjaftueshem për të vendosur Koncesionarin/Shoqerine Koncesionare në një pozicion ekonomik të njëjtë krahasuar me pozicionin në të cilin ndodhej, përpara ndodhjes së Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar, duke mbajtur parasysh të drejtat dhe detyrimet e vazhdueshme të Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare sipas kësaj Kontrate, Projektit dhe çdo marrëveshjeje tjetër të parashikuar në këtë Kontratë. Çdo Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar do të konsiderohet si Mospërbushje e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari/Shoqeria Koncesionare ka të drejtë të marrë të gjitha kompensimet dhe shpërblimet e parashikuara në këtë Kontratë dhe legjislacionin në fuqi, për zgjidhjen e Kontratës.

KREU 3

NENI 25

NDRYSHIMET NË LIGJ

- 25.1 Nëse ndodh një Ndryshim në Ligj, i cili nuk është Ndryshim Cilësues në Ligj dhe që kërkon nga Shoqëria Koncesionare të ndryshojë ose amendojë Projektin, cilësinë ose vëllimin e Shërbimeve, Shoqëria Koncesionare paraqet një propozim për ndryshim në përputhje me nenin 25.2.
- 25.2 Nëse një Ndryshim Cilësues në Ligj ndodh, ose pritët të ndodhë së shpejti, secila nga Palët mund të njoftojë Palën tjetër me shkrim për efektet e mundshme të një ndryshimi të tillë, duke specifikuar:
 - 25.2.1 Nëse kërkohet përjashtim nga përbushja e detyrimeve, duke përfshirë detyrimin për të arritur datën e programuar të përfundimit;
 - 25.2.2 Çdo ndryshim të nevojshëm në Shërbimet që shkaktohet apo rezulton nga një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj;
 - 25.2.3 Nëse kërkohet ndonjë ndryshim në kushtet e kësaj Kontrate ose të Dokumenteve të tjerë të Projektit;
 - 25.2.4 Nëse zbatimi i Ndryshimit Cilësues në Ligj do të rezultojë drejtpërdrejt në rritjen e kostove apo në humbjen e të ardhurave të Koncesionarit/Shoqerise Koncesionare;
 - 25.2.5 Çdo Shpenzim Kapital që kërkohet për të zbatuar Ndryshimin Cilësues në Ligj, ose që mund të kursehet;
 - 25.2.6 Çdo Miratim i Nevojshëm që do të kërkohet për të zbatuar një Ndryshim Cilësues në Ligj;
- 25.3 Nëse, si rezultat i një Ndryshimi Cilësues në Ligj:
 - 25.3.1 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të kryejë shërbimet,
 - 25.3.2 Shoqëria Koncesionare nuk është në gjendje të përbushë ndonjërin nga detyrimet e saj që rrjedhin nga kjo Kontratë; ose

25.3.3 Shoqërisë Koncesionare i kanë lindur ose do t'i lindin kosto, të cilat ndryshe nuk do t'i kishin lindur. ose nuk ka gjeneruar ose nuk do të gjenerojë të ardhura, të cilat ndryshe do t'i kishte gjeneruar po të mos kishte ndodhur një Ndryshim i tillë Cilësues në Ligj.

Shoqëria Koncesionare mund të sigurojë një përfitim në formën e:

25.3.4 Shtyrjes së duhur të datës së programuar të fillimit të Shërbimit, e cila do të jetë e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të filluar Shërbimin si dhe shtyrjen e Periudhës së Koncesionit.

25.3.5 Ndryshimet e nevojshme të Dokumenteve të Projektit për të marrë parasysh dhe reflektuar Ndryshimin Cilësues në Ligj;

25.3.6 Të drejtën e kompensimit; dhe/ose

25.3.7 Mos-aplikimin e dispozitave për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës për faj të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare.

Palët do të takohen për të diskutuar për efektet e sjella nga Ndryshimi Cilësues i Ligjit brenda 20 (njëzet) Ditësh Pune nga aprovimi i tij dhe do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje brenda 30 (tridhjetë) Ditësh Pune nga takimi i tyre.

NENI 26

DISPOZITA PËR ZGJIDHJEN E PARAKOHSHME TË KONTRATËS

26.1 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën:

26.1.1 Kur Koncesionari/Shoqëria Koncesionare nuk fillon kryerjen e shërbimeve për faj të tij brenda 9 (nëntë) muajve nga Data e Hyrjes në Fuqi. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në dispozitat e kësaj kontrate.

26.1.2 Në rast të moskryerjes në mënyrë të përsëritur të kalibrimin të pakten cdo 24 muaj kalendarikë të paisjeve matese perkatase ne pronesi te Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare per kryerjen e verifikimit dhe ne rast mos permbushjes se detyrimit ne lidhje me kalibrimin brenda nje periudhe 12 mujore pas afatit te sipercituar. Palet bien dakord qe kalibrimi eshte i nevojshem per te ruajtuar standartet e saktetise ne matje.

26.1.3 Kur Koncesionari transferon aksionet/kuotat e Shoqërisë së re koncesionare, pa miratim të Autoritetit Kontraktues sipas dispozitave të kësaj Kontrate.

26.1.4 Kur Shoqëria Koncesionare është shpallur e falimentuar dhe/ose ne likuidim nga nje vendim i formes se prere nga gjykata kompetente. në gjykatë në paaftesi paguese, për faj të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë vlerën e Sigurimit të Kontratës të parashikuar në dispozitat e kësaj kontrate.

Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e detyrimeve që kanë të bëjnë me dorezimin tek

Autoriteti Kontraktues. Palët bien dakord që dorëzimi do të bëhet brenda një afati kohor prej 60 ditësh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.

Nëse ky detyrim nuk përmbushet nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare atëherë, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e shërbimit, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

26.2 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës nga Koncesionari;

Koncesionari, ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë kur Autoriteti Kontraktues është në Shkelje të Vazhdueshme të detyrimeve të tij kontraktore dhe nuk i korrigjon këto shkelje. Koncesionari ka të drejtë të zgjidhë në mënyrë të njëanshme kontratën në kushtet e Mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues për një afat prej 10 (dhjetë) ditësh në një vit kalendarik përgjatë gjithë Periudhës së Koncesionit. Për të shmangur cdo dyshim, Koncesionari nuk mund të zgjidhë këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme në rast se Autoriteti Kontraktues ka përmbushur gjithë detyrimet sipas kësaj Kontrate.

26.3 Zgjidhja e kontratës për shkak të forcës madhore

Koncesionari ka të drejtë të zgjidhë kontratën e koncesionit:

26.3.1 në rast se edhe pas zbatimit dispozitave të kësaj Kontrate, nuk është arritur një zgjidhje në të mirë të projektit,

26.3.2 kur forca madhore zgjat më tepër se 6 muaj.

26.4 Pasojat e zgjidhjes së kontratës për shkak të forcës madhore

26.4.1 Zgjidhja e mosmarrëveshje që vijnë si pasojë e forcës madhore do të bëhet në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate.

26.4.2 Në rastin kur Palët nuk janë në gjendje të bien dakord me mirëbesim në lidhje me ndodhjen apo ekzistencën e një ngjarjeje të Forcës Madhore, kjo mosmarrëveshje do të zgjidhet përfundimisht në përputhje me procedurën për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, me kusht që, në çdo rast barra e provës në lidhje me ndodhjen apo ekzistencën e kësaj Ngjarje të Forcës Madhore, të jetë mbi Palën e Prekur.

26.5 Zgjidhja e kontratës nga secila palë;

Koncesionari ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

Megjithë plotësimin e kriterëve nga ana e Koncesionarit për aplikim për leje, liçenca dhe/ose akreditime ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ndërhyrjen e Autoritetit Kontraktues, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare nuk është pajisur me to jo për faj të tij, për fillimin e Shërbimit dhe/ose operimin e Projektit.

26.5.1 Vazhdimi i saj bëhet i pamundur jo për faj të koncesionarit.

Cdo kërkesë për zgjidhjen e kontratës nga ana e Koncesionarit duhet të shoqërohet me vendimin e Asamblesë së Aksionerëve të Koncesionarit.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:

26.5.2 Në rastet e parashikuara ne nenin 26.1 te kesaj Kontrate.

26.6 Njoftimi i zgjidhjes së kontratës.

Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me këtë nen, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër. Njoftimi duhet të përmbajë:

- i. Detajet e dukura duke nënvizuar shkakun e zgjidhjes;
- ii. Datën e përfundimit të kontratës, në rast të moskorrigjimit të shkeljes brenda 60 ditëve nga data e njoftimit;
- iii. Hollësitë e llogaritjes së pagesave si rezultat i zgjidhjes së kontratës;
- iv. Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

26.7 Zgjidhja e kontratës me marrëveshje mes palëve:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar mënyrën e kompensimit. Gjithësesi, Koncesionari ka të drejtë të kërkojë Sigurimin e Kontratës nëse ekziston, me kusht që të ketë paguar kompensimin e rënë dakort me negociim midis dy palëve.

26.8 Kompensimi në rast zgjidhjeje të Kontratës në mënyrë të njëanshme:

26.8.1 Në rast të zgjidhjes së kontratës nga Autoriteti Kontraktues në mënyrë të njëanshme, shuma e detyrimit që Autoriteti Kontraktues do ti paguajë Koncesionarit është e barabartë me shumën e të Ardhurave totale të parashikuara per periudhen e mbetur te Periudhës Koncesionare 20 vjecare, referuar Modelit Financiar te paraqitur ne proceduren konkurruese.

Marrja e kompensimit si më sipër nuk përjashton të drejtën e Koncesionarit të kërkojë kompensim për dëme morale ose imazhi për Koncesionarin, Shoqërine Koncesionare dhe kompanitë e lidhura.

26.9 Kompensimi në rast zgjidhjeje të Kontratës në mënyrë të njëanshme nga Koncesionari, në përputhje me dispozitën 26.2 e këtij Neni, atëherë:

26.9.1 Shuma e detyrimit që Autoriteti Kontraktues do ti paguajë Koncesionarit është e barabartë me shumën e të Ardhurave totale të parashikuara per periudhen e mbetur te Periudhës Koncesionare 20 vjecare referuar Modelit Financiar te paraqitur ne proceduren konkurruese.

Marrja e kompensimit si më sipër nuk përjashton të drejtën e Koncesionarit të kërkojë kompensim për dëme morale ose imazhi për Koncesionarin, Shoqërine Koncesionare dhe kompanitë e lidhura.

26.10 Kompensimi për Zgjidhje të Kontratës për Shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore është shuma e barabartë me vlerën e barabarte me:

- a) Detyrimet Kundrejt Huadhënësve
- b) Vlerën e Investimeve të realizuara deri në momentin e ndërprerjes së Kontratës për shkak të mospërbushjes nga Autoriteti Kontraktues,
- c) vlerën e detyrimeve ndaj të tretëve që lindin nga kjo Kontratë dhe që Koncesionari u detyrohet, përfshirë edhe fitimin e munguar të Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare, deri në datën e ndërprerjes së Kontratës,

- d) Pagesat për shkurtim të vendeve të punës dhe/ose kostove të tjera të cilat Koncesionari/Shoqëria Koncesionare duhet t'u paguajë punëmarrësve të tij si pasojë e përfundimit të kësaj Kontrate në bazë të Ligjit;
- e) Kostot e Zgjidhjes Përpara Kohe të Nënkontratave;
- f) Fitimin e munguar për periudhën e mbetur të koncesionit referuar normës reale të brendshme të kthimit.
- g) Çdo dëm tjetër apo e drejtë për kompensim që i lind Koncesionarit, ose që këtij i është dashur të përballojë apo mbulojë, si pasojë e mospërbushjes së Autoritetit Kontraktues si dhe të zgjidhjes së Kontratës për shkak të kësaj mospërbushjeje; dhe
- h) Kthimin e Garancisë së Kontratës, pas verifikimit dhe zbritjes së ndonjë detyrimi (nëse ka) nga Koncesionari, deri në datën e Mosplotësimit nga Autoriteti Kontraktues.

NENI 27 LIGJI I INTEPRETIMIT TË KONTRATËS

Palët bien dakort që kjo Kontratë do të interpretohet në përputhje me ligjin austriak në rast të zgjidhjes së pretendimeve të paleve nëpërmjet arbitrazhit.

NENI 28 LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Kjo Kontratë lidhet dhe rregullohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 29 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 29.1 Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.
- 29.2 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, do të jetë Qendra e Arbitrazhit e Dhomës Ndërkombtare të Tregtisë në Vienë. Palët bien dakord që çdo pretendim i ngritur prej tyre do të zgjidhet në mënyrë përfundimtare dhe detyruese për Palët, nga vendimi i arbitrit të vetëm caktuar në përputhje me rregulloren e Qendrës së Arbitrazhit e Dhomës Ndërkombtare të Tregtisë në Vienë. Arbitrazhi do të zhvillohet në Vienë në gjuhën angleze.
- 29.3 Fillimi apo vazhdimi i procedurave për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshjeje që lidhet me këtë Kontratë Koncesioni, nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

NENI 30
SANKSIONET

30.1 Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në dispozitat e kësaj kontrate, penalizon Koncesionarin/Shoqërinë Koncesionare si më poshtë:

- a. Për shkelje të afatit të vënies në punë të shërbimit sipas objektit të kësaj kontrate. 0.05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguar.
- b. Për moskryerje në total të investimeve dhe riinvestimeve për vlerën e të cilës është rënë dakord sipas nenit 9.1, Koncesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të perealizuara.
- c. Për çdo ditë vonesë për fillimin e kryerjes së shërbimit sipas objektit të kësaj kontrate penalizohet me 10 000 lekë.

30.2 Sanksionet paguhen në llogari të Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.

30.3 Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoriteti Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 30 ditësh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

30.4 Aplikimi dhe pagimi i penaliteteve sipas këtij neni nuk e çliron Koncesionarin nga permbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj Kontrate.

30.5 Keto penalitete do të mbahen nga sigurimi i Kontrates parashikuar në këtë Kontratë, duke patur parasysh se nëse vlera e këtij sigurimi nuk është mjaftueshëm për shlyerjen e penaliteteve, Koncesionari do ta plotësojë rast pas rasti.

30.6 Palet bien dakort se shkeljet e permendura më sipër nuk do të konsiderohen si Mospërmbushje nga Koncesionari.

NENI 31
RREGULLIMI I SHKELJEVE

31.1. Kur Autoriteti Kontraktues konstaton dhe provon se gjatë periudhës së koncesionit, Koncesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit (duke përfshirë aksionerin e Koncesionarit në perputhje me nenin 35). Koncesionari ka detyrimin të shqyrtojë konstatimet dhe provat e paraqitura nga Autoriteti Kontraktues dhe të njoftojë këto të fundit brenda 90 ditësh pune për refuzimin ose pranimin e konstatimit, me argumentet përkatëse dhe/ose shoqëruar me masat e ndermarra nga Koncesionari.

31.2. Në rastet kur Koncesionari pranon konstatimet dhe provat për shkelje, paraqitur nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari (në perputhje me vendimin e asamblese së aksionereve) do të ndermarre të gjithë hapat e duhur proceduriale në varesi të tipit të shkeljes, deri në kallzim

penal sipas rastit. Masat e referuara ne kete pikete Kontrates jane te aplikueshme dhe te zbatueshme dhe kur Koncesionari i konstaton dhe provon shkeljet nga ana e tij.

- 31.3. Kjo procedurë nuk e zhvesh Koncesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.
- 31.4. Palët bien dakord që për cdo rast konstatimi të mos kryerjes me korrektësi të Shërbimit nga një ose disa inspektorë apo punonjes të Shoqërisë Koncesionare, Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do të ketë 90 ditë kalendarike kohë nga data e konstatimit për marrjen e masave përkatëse ndaj inspektorit/punonjesit ose inspektorëve / punonjesve në fjalë. Palët bien dakord se asnjë rast i tillë nuk mund të konsiderohet si faj i Koncesionarit/Shoqërisë Koncesionare për efekt të Zgjidhjes së Parakohshme të Kontratës.

NENI 32 DËMSPËRBLIMET

- 32.1 Palët bien dakort dhe pranojnë, të mos dëmtojnë dhe të dëmshpërblejnë njëra tjetrën, në përputhje me kushtet e rëna dakort më poshtë, nga çdo dëm i shkaktuar nga mospërbushja e detyrimeve reciproke gjatë zbatimit të kësaj Kontrate.
- 32.2 Çdo dëmshpërblim i detyrueshëm për t'u paguar nga Pala dëmshpërblyese sipas këtij neni do të jetë i pagueshëm kur është përcaktuar nga një vendim arbitrazhi, titull ekzekutiv në kuptim të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, i cili vendos mbi shkeljet e kryera apo përcakton se ka mospërbushje detyrimesh dhe se dëmshpërblimi është i pagueshëm.
- 32.3 Çdo pagesë dëmshpërblyese ardhur nga pretendimet e Palëve do të kryhet sipas afateve dhe procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë në bazë të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

NENI 33 HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI I KONTRATËS

- 33.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit nga Palët të kësaj Kontrate, prodhon efekte juridike dhe është detyruese për palët duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi.
- 33.2 Kontrata Koncesionare mbaron me përfundimin e afatit 20 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet në lidhje me Datën Efektive.
- 33.3 Mbarimi i kontratës si përfundim i afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk i zhvesh Palët nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj njëra tjetrës.

NENI 34 KONFIDENCIALITETI

- 34.1 Secila nga Palët do të trajtojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet në lidhje me Projektin e Koncesionit, qofshin këto në formë të shkruar apo verbale, teknike apo tregtare, që u janë dhënë atyre nga ndonjë palë ose në emër të cilësdo Palë tjetër të Kontratës së

Konçesionit, dhe nuk duhet të përhapë tek një palë e tretë, të gjitha apo pjesë të dokumenteve dhe informacionit, pa pranimin e shkruar të Palës tjetër apo në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

- 34.2 Koncesionari/Shoqëria Koncesionare dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë konfidenciale të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga Pala tjetër në lidhje me Kontratën e Konçesionit.
- 34.3 Koncesionari/Shoqëria Koncesionare mund t'i japë nënkontraktorit dokumente, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktorin në mënyrë që ai të kryejë punën për të cilën është nënkontraktuar. Në rast të tillë Konçesionari duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që detyron ruajtjen e konfidencialitetit sipas parashikimit të dhënë në këtë nen..
- 34.4 Këto dispozita nuk do të zbatohen në rast se:
- a) Ky informacion ka qenë në zotërim të Palës që bën zbulimin, i cili nuk ka pasur detyrimin e konfidencialitetit në atë moment;
 - b) Ky informacion ishte përfutur nga një palë e tretë e cila nuk ka detyrimin e konfidencialitetit;
 - c) Në kohën e zbulimit ky informacion ka qenë për përdorim publik;
 - d) Informacioni është marrë, gjetur, zhvilluar në mënyrë të pavarur, pa pasur akses në Informacionin Konfidencial të Palës tjetër;
 - e) Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu nxjerrë sipas ligjit.
 - f) Në rastin kur Koncesionari/Shoqëria Koncesionare do të publikojë listën e Subjekteve të Detyruara me probleme, sipas dispozitave të kësaj kontrate.

NENI 35 NDRYSHIMET E KONTRATËS DHE NJOFTIMET

- 35.1 Kjo kontratë mund të pësojë ndryshim, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
- 35.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo shtojcave bashkëlidhur saj, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.
- 35.3 Palët bien dakord që në cdo rast Autoriteti Kontraktues detyrohet të njoftojë me postë rekomande si dhe me email, Koncesionarin, Shoqëria Koncesionare dhe Aksionerin/Aksioneret e Koncesionarit në adresat respektive, sic janë percaktuar në Shtojcën 4.

NENI 36 BASHKËPUNIMI MIDIS AUTORITETIT KONTRAKTUES DHE KONCESIONARIT

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të Projektit. Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet Palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit. Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari/Shoqëria Koncesionare, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontratë.

Adresat që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
Adresa: Blv. Dëshmorët e Kombit
Tiranë – Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria “NOA CONTROL” SHPK
Adresa: Rr. “Nikolla Tupe”, Ndërtesa
3. Kati I, Tiranë.

Per Shoqerine Koncesionare

“Shoqeria Koncesionare NOA INSPECT” SHPK
Adresa: Rr. “Nikolla Tupe”, Ndërtesa 3, Kati I, Tiranë.

Per Aksionerin

Gentian SULA
Adresa: Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 24/1, Ap.22, Tirane

NENI 37

GJUHA DHE KOPJET

Kjo kontratë është hartuar dhe nënshkruar në prani të noterit publik në gjuhën shqipe në 5 (pese) kopje origjinale, 2 (dy) kopje për Autoritetin Kontraktues, 2 (dy) kopje për Koncesionarin dhe 1 (nje) kopje për noterin.

PALËT

AUTORITETI KONTRAKTUES

Përfaqësuar nga :

znj/z. Arian Kraja

KONCESIONARI

Shoqëria:
“NOA CONTROL”

Përfaqësuar nga

znj/z. Anila Jari

SHOQERIA KONCESIONARE

SHOQERIA KONCESIONARE NOA
INSPECT” sh.p.k

Përfaqësuar nga :

znj/z. Matiel Hoxha

NOTERE

Gentiana Brati



SHTOJCAT

SHTOJCAT VIJUESE JANË PJESE PËRBËRËSE TË KËSAJ KONTRATE:

SHTOJCA 1 DOKUMENTAT E PROCEDURES KONKURRUESE

SHTOJCA 2 DOKUMENTET E DOREZUARA NE TENDER

SHTOJCA 3 OFERTA FINANCIARE DHE MODELI FINANCIAR

SHTOJCA 4 MARREDHENIET MES PALEVE

SHTOJCA 5 PROPOZIMI TEKNIK I KONCESIONARIT

SHTOJCA 6 SIGURIMI I KONTRATËS